

# RAPORT PARAPRAK I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS



SHTOJCA II PIKA 3.Ë, INSTALIME PËR PRODHIMIN E ENERGJISË HIDROELEKTRIKE,  
HEC-I SHINI.

INVESTITORI: KOKA SH.P.K.

KAPACITETI I PROJEKTUAR : 2 MW

ADRESA: DIBER BULQIZE MARTANESH DIBËR, BULQIZË, MARTANESH, KRASTË E  
VJETËR, RR. SH 50, GODINË, ZONA KADASTRALE 2267,NR. I PASURISË 2/70.

DIBER 2023

**RAPORT PARAPRAK I VNM-SË**

- a) *Hyrje*
- b) *Metodika e vnm-së, dhe kuadri ligjor mjedisor;*
- c) *Përshkrimi i projektit, vendodhja;*
- d) *Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet projekti, shoqëruar edhe me fotografi;*
- e) *Informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;*
- f) *Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundëshme, negative në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë tokë dhe ajër;*
- g) *Një përshkrim për shkarkimet e mundëshme në mjedis, të tilla si: ujrat e ndotur, gaze dhe pluhëra, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;*
- h) *Informacion për kohëzgjatjen e mundëshme të ndikimeve negative të identifikuar;*
- i) *Të dhëna për shtrirjen e mundëshme hapësimore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendodhja e projektit, dhe vlerat ndërkufitare që përfshihen në të;*
- j) *Mundësit e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësin e kthimit të mjedisit të ndikuar në sipërfaqe në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitim;*
- k) *Masat e mundëshme për shmangjen dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;*
- l) *Ndikimet e mundëshme në mjedisin ndërkufitarë (nëse projekti ka natyrë të tillë).*

## *Hyrje.*

Shqipëria është shumë e pasur me burime ujore dhe me një peisazh të mrekullueshëm natyror. Kushtet hidrografike, gjeomorfologjike dhe klimaterike formojnë rrjedhje natyrore ujëshumë dhe rënie të mëdha, të cilat krijojnë mundësinë për shfrytëzimin hidroenergjitik me interesa të madhe ekonomike.

Këto karakteristika natyrore të mrekullueshme shpalosen në mënyrë të theksuar edhe në zonën në studim dhe më konkretisht të perroit e Bizës dhe Valit, dege te lumit Mat, pranë fshatit Val Nj Martanesh, Bashkia Bulqize, Dibër.

Prodhimi i energjisë sot në Shqipëri është kryesisht nga hidrocentralet e mesëm dhe të mëdhenj. Kapaciteti hidroenergjitik i vëndit tonë llogaritet me një fuqi teknikisht të shfrytëzueshme prej rreth 4 milionë kw dhe me një prodhim energjie vjetore rreth 20 deri 22 miliardë kw/h. Sot kjo energji është shfrytëzuar në masën rreth 35 %.

Nga vlera e hidroenergjisë së lartë përmëndur, mbi 5% të saj i takojnë hidrocentraleve të vegjël me fuqi deri 5000 kw.

Aktualisht Shqipëria prodhon rreth  $6 \times 10^9$  kw/h në vit, prej të cilëve rreth  $5 \times 10^9$  shkojnë në përdoruesit e vëndit, ndërkohë që nevojat minimale sot janë rreth  $7 \times 10^9$  kw/h në vit. Për pasojë Shqipëria ka një defiçit prej rreth  $2 \times 10^9$  kw/h në vit, të cilën detyrohet ta importojmë nga jashtë vëndit.

Pra jo vetëm që prodhimi i energjisë në Shqipëri është i ulët krahasuar me vëndet tjera të rajonit (rreth 2000 kw/h për frymë në vit), por mesatarisht rreth 25% deri 35% nevojave të vëndit importohet nga jashtë.

Një rëndësi të vecantë, me ngrohjen globale, merr edhe zhvillimi hidroenergjitik në zonat e mundëshme të saj duke dhënë një impakt pozitiv në prodhimin e energjisë së pastër duke përmirësuar ekosistemin dhe ekologjinë e rajonit.

Gjithashtu krijon mundësinë e zhvillimit të infrastrukturës lokale dhe ndërtimin e një cikli të mbyllur bujqësor (si ai agroindustrial, industria e lehtë ushqimore, etj.)

Ndërtimi i hidrocentraleve të vegjël e të mesëm krijon një mundësi pozitive për uljen e humbjeve në trasmetim në zonat e thella, stabilizon tensionet dhe garanton vijueshmëri në furnizimin me energji elektrike konsumatorëve.

Kohët e fundit është kushtuar një vëndje të veçante shfrytëzimit hidroenergjitik dhe atyre alternativave të tjera për të zvogëluar raportin e HEC-eve me TEC-et duke krijuar mundësinë e uljes e dioksidit të karbonit CO<sub>2</sub> në atmosferë, sipas prespektivave dhe marrëveshjeve të herëpas-herëshme globale me kuaotat përkatëse.

Me kërkesë të shoqërisë Koka Sh.p.k po përpilohet studimi i gjëndjes së ndërtimit të “Hec SHINI” me vendodhje ne Perroit e Bizës dega e lumit Mat e cila derdhet në këtë lum nëpërmjet grykës së Valit në rrugë nëntokësore në bregun e majt të lumit Mat. Perroi i Bizës kufizohet nga veriu me pellgun e perroit Xixullit degë e rëndësishme në pjesën e lumit Mat.

Në këtë studim do të meren parasysh të gjitha rekomandimet e dhëna në zbatim të ligjit nr 10 440 “Për Vlersimin e Ndikimit në Mjedis, i ndryshuar si dhe VKM nr 686 datë 29.08.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlersimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.

Vlerësimi teknik i shkurtër mjedisor bëhet për të demonstruar nga pikëpamja e vlerësimit mjedisor projekt-idenë e propozuar për ndërtimin e Hec Shini.

Ndërtimi i ketij Hec-i do të jetë në një zonë me dendësi të mesme mund të themi që është në periferi të qytetit të Bulqizës, e propozura për zonë pasi nga studimet e bëra rezulton të ketë burime ujore të mjaftueshme për shfrytëzimin e tyre dhe prodhimin e energjisë elektrike investime dhe aktiviteteteve të cilët jan shumë miqësore me mjedisin.

Gjatë punimeve për ndërtimin e ketij Hec-i ndikimet mjedisore do të ndeshen në disa aspekte.

Ndikimet pozitive dhe negative do të jenë të tilla si gjatë fazës ndërtimore të tij, ashtu dhe pas përfundimit të punimeve.

Pra, vlerësimi i shkurtër teknik dhe mjedisor jep informacionin:

- Për projekt-idenë që do të realizohet,
- Vlerësimin e ndikimeve negative dhe pozitive në mjedis, si dhe masat që do të marrë investitori për zbatimin e kriterëve të nevojshme për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit.

## *Metodika e vnm-së dhe kuadri ligjor mjedisor.*

### Qëllimi i VNM-së

VNM është një proces sistematik për të përcaktuar dhe vlerësuar efektet apo ndikimet në mjedis të një veprimtarie apo projekti të caktuar. Në një situatë normale, ky proces aplikohet përpara se të merren vendimet dhe të fillojnë angazhimet për realizimin e projektit. Por sidoqoftë, dhe në çdo kohë, efektet sociale, kulturore dhe shëndetësore janë konsideruar si pjesë integrale e VNM-së. Kujdes i veçantë i kushtohet praktikave të VNM-ë për të parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative të veprimeve të ndërmarra. Qëllimi i VNM-së është të:

Të japë informacion për vendimarrësit për pasojat mjedisore të studimet e propozuara. Të promovojë zhvillimin miqësor dhe të qëndrueshëm me mjedisin duke identifikuar masat e duhura për përmirësimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis.

Reduktimi i ndikimeve në mjedis arrihet nëse një zhvillim bëhet i qëndrueshëm me mjedisin. Këto ndikime janë mjaft komplekse, më të mëdha në shkallë dhe për më tepër shtrijnë pasojat e tyre më shumë se 10 vjet më parë ku u fut koncepti i VNM-së në vendin tonë. Si rezultat, VNM-ja është kthyer në një dokument kyç për vendimarrjen për miratimin e një zhvillimi të propozuar.

Në aspektin ndërkombëtar, roli i VNM-së është njohur në Principin e 17 të Deklaratës për mjedisin dhe Zhvillimin. VNM, i një instrument kombëtar duhet të aplikohet për aktivitetet e propozuara të cilat pritet që të kenë ndikim negativ në mjedis dhe janë subjekt i një vendimarrje të një autoriteti kombëtar.

Qëllimi dhe objektivat e VNM mund të ndahen në dy kategori.

Qëllimi i parë drejtpërdrejtë është të informojë procesin e vendimarrjes duke identifikuar e konsiderueshme potenciale në mjedis dhe rreziqet e përfitimet e projektit dhe zhvillimit të propozuar.

Qëllimi përfundimtar afatgjatë i VNM-së është të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm duke siguruar që propozimet e projektit nuk minojnë burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mirëqënien, stilin e jetës dhe jetesën e komunitet si dhe të njerëzve që lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurtër dhe të drejtpërdrejtë të VNM-së:

- Përmirësim nga pikëpamja mjedisore i propozimit dhe projektit.
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrën e duhur dhe me efikasitet.
- Identifikon masat e duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit apo propozimit.
- Lehtëson informimin e vendimarrësit, duke përfshirë vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore për zbatimin e projektit të propozuar.

Objektivat afatgjatë të VNM-së janë:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut.
- Parashikon dhe përjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe dëmtimet serioze të mjedisit.
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentët përbërës të ekosistemeve.
- Përmirëson aspektet sociale të projektit.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë kërkohet: “Mirëmbajtje e një mjedisi tepër të shëndetshëm dhe ekologjik për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm”. Kjo por edhe opinioni i gjithë shoqërisë i shprehur nëpërmejt ligjeve të tjerë, detyron marrjen e masave imediate për rehabilitimin e mjedisit të degraduar gjatë “epokës së industrializimit socialist” dhe ruajtjen e tij nga aktivitetet e sotme prodhuese/ridertuese që gjithashtu shkaktojnë dëmtime të mjedisit. Legjislacioni në lidhje me ruajtjen e mjedisit është në përputhje me normativat europiane të mbrojtjes së tij ndonëse cilësia mjedisore është ende në parametra mjaft të ulët.

Ligji i parë për mbrojtjen mjedisore daton në vitin 1993 dhe shprehet se: “të gjitha veprimtaritë e personave fizike dhe juridik, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të nënshtrohen vlersimeve mjedisore” Më tej, Ligji Nr. 8934, mbi mbrojtjen mjedisore përcakton se: “Mbrojtja e mjedisit është detyrim i” të gjithë shtetasve dhe individëve me veprimtari në Shqipëri”

Ky raport hartohet mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrëse për liçensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.

Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

Parimet e mbrojtjes së mjedisit:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjelltë dhe bashkëpunimit
- Parimi ndotësi paguan
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit Mbrojtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e integruar të përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh në fazën e planifikimit të zhvillimit të një territori të caktuar.

Mbrojtja e përbërsve të mjedisit klasifikohet në:

- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujrave
- Mbrojtja e tokës
- Mbrojtja e natyrës
- Ndryshimet klimatike.

Legjislacioni i VNM

Sa më sipër, ky Raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, është mbështetur në legjislacionin mjedisor si më poshtë dhe ka për qëllim që të identifikojë, parashikojë dhe parandalojë ndikimin e këtij aktiviteti në mjedis.

Kuadri ligjor për VNM-në sigurohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri Ligji Për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligji për Vleresimin e Ndikimit në Mjedis. Këto ligje së fundmi janë përafuar plotësisht me ligjet e Bashkimit Europian për mbrojtjen e mjedisit dhe Vleresimin e Ndikimit në Mjedis.

Ligji mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM-së) përcakton tipin dhe shkallën e projekteve apo veprimtarive që kërkojnë VNM para implementimit.

Kategoritë e VNM-ve janë:

- VNM-ë paraprake: Ky vlen për projekte që mund të kenë impakte potenciale më të vegjël në përmasa që sërish kërkojnë një vleresim profesional të impakteve të tyre. Këto përfshijnë projekte që janë listuar në Shojcën 2 të Ligjit për VNM-në dhe ndryshime apo rehabilitime të projekteve të listuar në Shtojcën 1
- VNM-ja e Thelluar: Ky vlen për projekte me impakte potencialisht të konsiderueshme, siç figurojnë në listën e Shojcës 1 të Ligjit, ato projekte të listuara në Shtojcën 2 për të cilët Agjencia Kombëtare e Mjedisit mendon se do të kenë një impakt të konsiderueshëm mbi mjedisin (bazuar në informacionin e siguruar nga propozuesi në kohën e aplikimit) dhe veprimtaritë që janë për tu implementuar në zonat e mbrojtura apo zona bregdetare të Republikës së Shqipërisë.

Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponente të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit. Kështu, ndër ligjet më specifike që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me projektin në vleresim, mund të përmendim:

Në ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” theksohet në kapitullin V (VNM) neni 25 se:

Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërimit të lejeve përkatëse të zhvillimit. Në Ligjin Nr.10 440, datë 07.07.2011 “Për Vleresimin e Ndikimit në Mjedis” në kreun II, neni 7 për “Proçedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis” thuhet:



Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vleresimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

Procedura e vleresimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vleresimit të ndikimit në mjedis, i cili në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;
- b) raporti i thelluar i VNM-se për projektet e shtojcës I.

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin indentifikimin, saktësimin dhe vlerësimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të projektit në mjedisin ku do të zbatohet, si dhe përcaktimi i masave për të parandaluar dhe zbutur dëmtimet në mjedis që në fazën fillestare të tij.

Përmbledhje e kuadrit ligjor.

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore mjedisore, si rezultat i ndryshimeve degraduese mjedisore të cilat kanë ardhur si rezultat i industrisë para viteve 90-të dhe zhvillimeve të fundit në fushën e ndërtimit dhe industrisë. Menaxhimi dhe mbrotja e mjedisit janë pjesë e Legjislacionit Shqiptar, Neni 59 (d) shkruhet se: Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësimin e nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

Neni d): një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Sipas Ligjit Nr. 10 431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është autoriteti përgjegjës për rishikimin e dokumentit VNM-së të përgatitur nga ekspertet e licencuar prej Ministrisë së Mjedisit. Përveç Ligjit Nr. 10 431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratori edhe Ligjin Nr. 10 440 datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Ky ligj është zhvilluar dhe bazuar në Direktivat e EO dhe praktikat ndërkombetare të Vleresimit të Ndikimit në Mjedis.



***Ndër ligjet e tjera të legjislacionit kombëtar në lidhje me aktivitetin në fjalë përfshihen edhe ligjet dhe vkm e mëposhtëme:***

- Ligji Nr 10 431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”
- Ligji Nr 10 440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”
- Ligji Nr 8652 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore, datë 31 Korrik 2000”
- Ligj Nr. 10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”
- Ligji Nr. 10 463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
- Ligj Nr. 10 119 datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”
- Ligji Nr. 8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.
- Ligji Nr. 9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.
- Ligji Nr. 10 081, datë 23.02.2009. “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligj Nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujerave të ndotura”.
- Ligj Nr. 10 266 për disa ndryshime në ligjin 8897 për mbrojtjen e ajrit nga Ndotja.
- Ligj nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”
- Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”
- Vendim nr. 798, datë 29.9.2010 Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”
- Vendim Nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”
- Vendimi Nr. 805, datë 04.12.2003 Për miratimin e listes se veprimtarive, që ndikojne në mjedis, për të cilat kërkohet Leje Mjedisore”.
- Vendimi Nr. 994, datë 02.07.2008 “Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin”.
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Për menaxhimin e zhurmave”
- Vendim Nr. 313, datë. 09.05.2012 “Për rregulloren e mbrojtjes së publikut nga shkarkimet në mjedis”
- Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”
- Vendim Nr. 178, datë 6.3.2012 “Për incinerimin e mbetjeve”
- Vendim Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”
- Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujorepritëse”
- Vendim Nr.435 datë 12.09.2002, “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
- Vendim Nr. 538 datë .26.05.2009 “Për liçenat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregulla të tjera”
- Vendim Nr. 16, datë 14.01.2012 “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor”
- Vendim Nr. 13, datë 04.01.2013 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”
- Vendim i KM Nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, te kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave

të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”

- Vendim Nr. 435, datë 12.9.2002 “ Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër”.
- Vendim Nr. 652, datë 14.09.2016 “Për rregullat dhe kriteret e menaxhimit të mbetjeve nga gomat e përdorura”
- Vendimi Nr 371, datë 11.06.2014 “ Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”.
- Vendimi Nr 675, datë 07.11.2012 “ Për rregullat dhe procedurat për asgjësimin e vajrave të përdorura”
- Vendimi Nr 229 datë 23.04.2014 “ Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”
- Vendim nr. 866, datë 4.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”
- Vendimi Nr 575 datë 24.06.2015 “ Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”
- Udhëzim i Ministrisë së Mjedisit Nr. 5, datë 28.12.2007 “Për tarifën e shërbimit për Leje Mjedisore”.
- Udhëzim Nr. 8, dt.27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në Republikën e Shqipërisë
- Udhëzim Nr. 1037-1, datë 12.04.2011 “Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore”

### ***Kuadri Ligjor European***

Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përfaqësojë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat kryesore:

- Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill 1999, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit.
- Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës, Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave.
- Direktivës KE 42/2001 (të Këshillit të Evropës), mbi VNMS dhe VSM.
- Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës (21 Maj 2008) ” Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën”.
- Direktiva 75/442/CEE e Këshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
- Direktiva 91/689/CEE e Këshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezikshme.
- Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pashoave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin.
- Direktiva 85/337/CEE e Këshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pashoave të Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.
- Direktiva e Këshillit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.
- Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, SO<sub>2</sub>, lëndët grimcore dhe Pb në ajër.

- Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 per cilesine e ujerave te embla
- Direktiva 99/61/CE Për gropat e mbetjeve.
- Direktiva 91/689/CE Për Mbetjet e Rrezikshme.

Kuadri ligjor për mbrojtjen e mjedisit në Republikën e Shqipërisë është në përputhje me standardet e BE-së.

Gjatë dhjetë vjeçarit të fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore mjedisore, si rezultat i degradimit mjedisor të vendit gjatë zhvillimit industrial që mori vendi gjatë viteve 50. Politikat e përpiluara për mjedisin në ditët e sotme janë pasqyruar në Aktet Ligjore dhe Nënligjore të Mjedisit gjatë 2000-2009, si dhe në disa ligje e vkm të miratuara më vonë se këto vite.

Hartimi i ketij raporti VNM-je është bërë në përputhje me ligjin Nr. 10 440, datë 07.07. 2011, “Per Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” ku sipas nenit 9 te ketij ligji, percaktohen edhe projektet qe i nenshtrohen procedures Paraprake te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, sipas shtojces II (pika 3 ë) Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike.

### ***Përshkrimi i projektit, vendndodhja.***


Në këtë raport paraqitet analiza e projektit për ndërtimin e Hec Shini i cili shfrytëzon ujrat e Përroi e Bizës dhe Valit dega e lumit Mat e cila derdhet në këtë lum nëpërmjet grykës së Valit në rrugë nëntokësore në bregun e majt të lumit Mat. Përroi i Bizës kufizohet nga veriu me pellgun e përroit Xixullit degë e rëndësishme në pjesën e lumit Mat, Bulqizë.

Kërkesa për marrjen e këtij hidrocentrali bazohet në VKM 822 date 07.10.2015, “Për Miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncensionit”. Në pellgjet e përrenjëve Biz dhe Val, nuk janë dhënë koncensionet të tjerë. Studimi i fizibilitetit është kryer nga studio e projektimit “Instituti Dekliada Alb” Shpk, mbi bazën e të cilit është marr edhe miratimi paraprak për ndërtimin e këtij Hec-i. Sipas këtij studimi fizibiliteti, uji parashikohet të merret në fund të pellgut të përroit të Bizës rreth 700 m mbi shpellën natyrale të përroit të Bizës, dhe nëpërmjet një derivacioni me gjatësi rreth 9.5 km, uji dërgohet në Basen të presionit në tarracën lindore të luginës së përroit të Valit, dhe më tej me anë të një tubacioni me gjatësi rreth 1800 m dërgohet në ndërtesë të centralit e cila ndërtohet në kanalën e derivacionit të Hec “Stavec-1” në trungun e lumit Mat. Sipas kësaj skeme shfrytëzohet një rënjë ndërmjet kuotave 1220 m dhe 600 m.

Përroi e Bizës dhe Valit dega e lumit Mat e cila derdhet në këtë lum nëpërmjet grykës së Valit në rrugë nëntokësore në bregun e majt të lumit Mat. Përroi i Bizës kufizohet nga veriu me pellgun e përroit Xixullit degë e rëndësishme në pjesën e lumit Mat. Vija ujëndarse kalon në malin e zonës së Martaneshit (+1846 m m.n.d.) dhe qafën e Himës (+1460m m.n.d). Në lindje kufizohet me pjesën e sipërme të pellgut ujëmbledhës të përroit të Xixlles dhe të përroit të Pervalles dhe malin me kuotë +1517 m m.n.d. Në jug kufizohet me pjesën e sipërme të pellgut ujëmbledhës të përroit të Pervallës, degë kryesore e lumit të Rrapunit që derdhet në lumin Shkumbin. Në perëndim përroi i Bizës kufizohet me pjesën e sipërme të pellgut ujëmbledhës të lumit Erzen dhe fillon nga qafa e Rinasit qafa e Monumentit dhe me malin e Spones (+1617m m.n.d.) Lugina e përroit të Bizës fillon nga kuota +1460 m m.n.d. nga qafa e Himes dhe zbret në fushën e Bizës në kuotën +1200 m m.n.d, ajo është në formë gjatësore. Përroi i Kaprollit që zbret nga lindja e pellgut ujëmbledhës të përroit të Bizës dhe përroi i Bizës që zbret nga jugu pellgu ujëmbledhës nga mali Sukes (+1542), zbresin në fushën e Bizës me kuotë afërsisht +1200 m m.n.d. Fusha e Bizës gjendet në skajin jug-lindor të malit me Gropa dhe mund të përfshihet edhe në të, por më e arsyeshme është të studiohet me Martaneshin. Ajo është 2.5 km e gjatë dhe 2 km e gjerë dhe ka një sipërfaqe prej 3.7 km. Për nga gjeneza është një gropë karstike e formuar në një struktur sinklinale dytësore në kontakt me fliшет. Në përgjithësi ka një fund të rregullt e të sheshtë, sidomos gjysma jugore. Prania e tokave të zeza si dhe kushtet e veçanta topografike të fushës së Bizës të bëjnë të mendosh se dikur, fundi i saj të jetë zënë nga ndonjë liqen karstik i cili më vonë u zbrast nëpërmjet grykës së Valit. Pjesa më e madhe e pellgut ujëmbledhës përbëhet nga formacione karbonike flishore, gëlqerore, janë të karstëzuar dhe konglomeratesh argjila ranore, mergele dhe depozitime flishoidale. Formacionet gjeologjike dhe tokësore që përbëjnë pellgun ujëmbledhës janë mesatarisht të përshkueshëm dhe po ashtu të gërryeshëm. Në përgjithësi, pellgu ujëmbledhës i përroit të Bizës është i veshur me bimësi pyjore, vetëm në pjesën ku përroi hyn në grykën e Valit rreth 3.4 km është me bimësi të rrallë




*Pellgu ujëmbledhës i përroit të Bizës.*





*Harta hidrologjike e pellgut të përroit të Bizës.*






HIDROCENTRALI SHIN







Përroi i Bizes është njëra nga degët e pjesës së sipërme të lumit Mat, ai ka një pellg ujëmbledhës në derdhje me një sipërfaqe rreth 36.5 km. Pellgu i këtij përroi shtrihet 100% në territorin e Shqipërisë. Përroi i Bizes formohet nga rrjedhja e ujërave të reshjeve në lindje të malit me Gropa dhe karakterizohet nga fakti që këto ujëra nuk derdhen në mënyrë natyrale në luginën e Valit por në një shpellë e njohur me emrin Shpella e Valit.

Arsyeja e futjes së ujit në shpellë është grumbulli masiv i gureve që kanë rrëshqitur në kohë prehistorike, nga dy shpatet e luginës së Valit duke krijuar një digë natyrale me një lartësi rreth 30 m. Formacioni gëlqeror i malit në anën e djathtë të luginës së Valit, me një karakteristik shumë të zhvilluar, ka krijuar mundësinë e rrjedhjes nëntokësore të ujit pa krijuar ndonjë rezervuar.

Duke parë materialin e depozituar në hyrje të shpellës arrihet në konkluzion se gjatë rreshjeve të dendura në hyrje të shpellës mund të formohet një pellg uji me thellësi rreth 4-5 m. Më poshtë ilustrojmë fenomenet e përshkruara më lart. Morfologjia e pellgut ujëmbledhës nga burimet deri në derdhjen në lumin Mat paraqitet malore e me lugina të thella e të ngushta.

Fotot më poshte paraqesin disa pamje ajrore të zonës ku janë identifikuar Vepra e marrjes, Ndërtesa e Centralit “Shini” dhe objektet fqinje, Ndërtesa e Hec “Peshku” dhe Vepra e Marrjes së Hec “Stavec-1”. Fotot e mëposhtme paraqesin disa pamje të zonës ku do të ndërtohen Vepra e marrjes, Tubacioni i turbinave dhe ndërtesa e Hec “Shini”.

***Pamje e luginës së Valit nga pika ku pozicionohet shpella e Valit dhe pjesa e mbushur me aluvione e luginës së Valit.***






*Foto të hyrjes së shpellës së Valit, aluviolet e depozituara.*



*Pamje satelitore e luginës.*








*Pamja ku do të ndërtohet Vepra e Marrjes së Hec Shini.*



*Tubacioni i turbinave.*





*Zona ku do të ndërtohet godina e centralit*

Sipas projektit të miratuar ne fazen e fizibilitetit vepra e marrjes është parashikuar të ndërtohet në përroin e Bizës në kuotën 1220 m mnd (shumë afër qendres se banuar Bizë). Nga vepra e marrjes me anë të një derivacioni rreth 9.5 km me tub PVC, i trasuar në shpatin verilindor të rrjedhjes së përroit të Bizës dhe Valit, uji dërgohet në basenin e presionit në kuotën 1182 m në shpatin jugor te lumit Mat ne afersi te lagjes Lenaj. Nga baseni i presionit me anë të tubacionit të turbinave uji dërgohet në ndërtesën e centralit e cila ndodhet në kuotën 600 m në krahun e majtë të Lumit Mat poshtë vepres së marrjes së Hec Stavec- 1 dhe Godinës së Centralit të Hec Peshkut.

Fuqia e vendosur e ketij hidrocentrali eshte pranuar 1940 kW, me nje prodhim mesatar te energjise rreth 7.37 Miljon kWh. Nga studimi i fizibilitetit nuk del e qarte se si do te pershkoje derivacioni mbushjen e madhe me material te lugines se Valit ne nje gjatesi rreth 1300 m. Pika me e larte e kesaj mbushjejeeshte rreth 30 m mbi Uren egzistuese e cila eshte ne kuoten 1200 m. Duke patur parasysh se vepra e marrjes ne fizibilitet eshte parashikuar te ndertohet ne kuoten 1220 m, rezulton qe ajo ndertohet pothuaj ne afersi te qendres se banuar duke zvogluar pellgun ujembledhes me rreth 30% dhe perseri nenkalimi i mbushjes do te duhet bere me ane te nje Tuneli ose nje Useku me thellesi mbi 10 m.

Sa me siper, zgjidhja me veper marrje ne kuoten 1220 m nuk duket e arsyeshme dhe si pasoje eshte pranuar qe vepra e marrjes te ndertohet tek Ura ne hyrje te grykes se Valit rreth 700 m para derdhjes se ujerave ne shpellen karstike te Valit. Po keshtu, derivacioni nuk eshte e mundur te realizohet me kanal ashtu siç eshte parashikuar pasi duhet ne disa pjese te kalohet me tunel, gjë që ka diktuar studimin e mundesive te tjera.



Hidrocentrali "Shini", parashikohet të ndërtohet në rrjedhen e sipërme te perroit te Bizes, pranë fshatit Val Martanesh, pjesë e njësise administrative Martanesh, Qarku Diher, Rrethi Bulqize. Subjekti "Koka" shpk ka bërë rishikim të projektit me qëllim mos cënimit (shmangien apo mbrojtjen) e zonës së mbrojtur "Mali me Gropa Bizë Martanesh", e cila është shpallur Peisazhi Mbrojtur me VKM, Nr. 49, datë 31.01.2007 (Kategoria V). Kjo bazuar në Ligjin 8906 datë 6.6.2002 Per Zonat e Mbrojtura" i ndryshuar me Ligjin Nr. 9868 datë 4.2.2008.

Në këto kushte, subjekti "Koka" sh.p.k me miratim të Ministrisë së Mjedisit ka bërë ndryshimet si më poshtë:

Vepra e marrjes është zhvendosur përkatësisht me koordinatat:

Nr	X	Y
1	4579103.86	4430456.03


Derivacioni do të ketë një gjatësi totale prej rreth 7080 m.

Ai përbëhet nga tre pjesë:

- Pjesa e parë, kanal i hapur pa presion me gjatësi 190 m dhe permasa të seksionit tërthor  $b \times H = 0.5 \times 0.8$  m;
- Pjesa e dytë, një tunel me gjatësi 4990 m me permasa  $b \times H = 3.5 \times 4.5$  m. Në mes të bazës së tunelit parashikohet të ndërtohet një kanal me permasa  $b \times H = 0.5 \times 0.8$  m;
- Pjesa e tretë, kanal i hapur pa presion me gjatësi 1900 m dhe permasa të seksionit tërthor  $b \times H = 0.5 \times 0.8$  m;

Nr	X	Y
Baseni presionit	4585417.10	4431026.55
Godina centralit	4586182.97	4431662.56
Vepra e marrjes	4579103.86	4430456.03

Harta.





***Kordinatat.***

Më poshtë në tabelen po japim edhe koordinatat hidroteknike që parashikohen të ndërtohen për Hec Shini:

Nr	X	Y
Baseni presionit	4585417.10	4431026.55
Godina centralit	4586182.97	4431662.56
Vepra e marrjes	4579103.86	4430456.03

**Qëllimi themelor i projektit**

Është prodhimi i pastër i energjisë elektrike duke realizuar një vlerësim të përgjithshëm të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore të projektit me synim parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.

Studimi i plotë i rezervave lokale hidroenergjitike natyrore të basenit shi-mbledhës të përroit të përroit të Bizës dhe Valit degë e lumit Mat, si dhe ndërtimi i hidrocentralit në këtë zonë, do të krijojë kushte shumë të favorëshme për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në zonën e Fshatrave përreth dhe Martaneshit, dhe baza e këtij zhvillimi të qëndrueshëm rajonal do të jetë edhe prodhimi i energjisë elektrike nga ky hidrocentral.

***Përshkrimi i veprave inxhinierike.******Veprat e marrjes***

Hidrocentrali që është parashikuar të ndërtohet është me një vepra marrje të tipit malor. Në përgjithësi te lumenjtë malorë dhe përrenjtë rrjedhja karakterizohet me luhate të theksuara të prurjes në vlerë dhe në kohë si dhe me përmbajtje të lëndës së ngurtë fundore dhe pezull që ndyshon në sasi dhe në përbërje granulometrike. Nga pikëpamja granulometrike madhësia e lëndës së ngurtë ndryshon nga përmasat e gurëve të mëdhenj deri në grimca shumë të vogla dhe koloidale. Të tillë janë edhe përrenjtë gjatë gjithë gjatësisë së tij nga burimet deri në derdhje në lumin Mat. Në kushte të tilla veprat e marrjes më të përshtatshme do të ishin ato me zgarë e tipit Tirolezë.

*Veprat e marrjeve të Hec-it në studim janë llogaritur në dy aspekte:*

**a-) E para** që të kalojë prurjen llogaritëse të hidrocentraleve nëpërmjet galerisë ujëmarrëse me zgarë. Në këtë rast prurja llogaritëse e hidrocentralit është përcaktuar e barabartë me prurjen e turbinave, pra galeria ujëmarrëse duhet të projektohet e tillë që të kalojë prurjen llogaritëse të hidrocentralit (Prurjen e turbinave). Megjithatë meqënëse kemi të bëjmë me prurje relativisht të vogla prurja që quhet të kalojë nëpër galerinë ujëmarrëse për çdo Veper Marrje është pranuar

më e madhe dhe shitesa e prurjes bëhet vetëm për efekt të shpëlarjes të sedimenteve që kanë ngelur në dekantues, i cili vendoset menjëherë pas Veprës së marrjes. Pra për secilen Veper prurja që do të kalojë në galerinë ujëmarrëse është pranuar më e madhe se prurja llogaritëse e turbinave në masën 1.5 deri 2 herë më shumë, në varësi të prurjes llogaritëse të turbinave. Kjo do të thotë që shpëlarjet normale mund të bëhen në periudha kur prurja në secilin aks marrje të përroit është më e madhe se sa prurja e hidrocentraleve të paktën 1.5 deri 2 herë. Përmasimi i galerive ujëmarrëse është bërë duke i pranuar ato të punojnë pa presion në formë kanalesh të hapur me mure anësorë vertikale. Pra galeritë ujëmarrëse janë llogaritur të punojnë pa presion me përmasa dhe pjerësi të tillë të shtratis për të kaluar prurjen e parashikuar të turbinave dhe të shpëlarjes së sedimenteve që hyjnë në galeri dhe depozitohen në fund të saj dhe në dekantues. Në rastet e prurjeve shumë të vogla të Hec-eve, përmasimi i galerive ujëmarrëse është konstruktiv. Galeritë ujëmarrëse në fund janë paisur me porta shkarkimi fundore ose me saraçineska për të bërë shpëlarjen e sedimenteve.

**b-) E dyta** që prita kapërderdhëse e Veprës së marrjes për çdo Hec të transportojë prurjen maksimale për plotën me siguri 1%, të përcaktuar nga studimi hidrologjik.

Plotat maksimale me siguri të ndryshme për secilen Veper marrje janë dhënë në studimin hidrologjik bashkëngjitur dosjes. Llogaritja e hapësirave kapërderdhëse të pritave është bërë duke i konsideruar ato si kapërderdhës me profil praktik dhe me anën e formulës kryesore të kapërderdhësave dhe duke pranuar koeficientin e prurjes së kapërderdhësit  $m=0.36$  është përcaktuar niveli maksimal i ujit mbi pritën kapërderdhëse. Përmasimi i detajuar dhe hollësi të tjera të veprave të marrjeve për çdo Hec të veçantë do të përcaktohen në fazat e mëtejshme të projektit të zbatimit. Bashkëngjitur studimit të fisibilitetit janë dhënë për secilin Hec prerje gjatësore, tërthore dhe detaje të tjera të veprave të marrjes të ujit.

### ***Sistemi i Derivacioneve.***

Sistemet e derivacionit shërbejnë për të kaluar prurjen e turbinave transit nga *vepra e marrjes* te baseni i presionit. Për të gjitha Hec-et sistemi i derivacioneve i çdo lloji qoftë, tunel pa presionose tub pa presion, ose i kombinuar me tunel dhe tubacion çeliku pa presion janë llogaritur humbjet hidraulike si diferencë midis nivelit të ujit në *veprën e marrjes* dhe nivelit të ujit në basenin e presionit. Përmasimi i tyre në çdo rast është bërë në bazë të llogaritjeve hidraulike (shih llogaritjet përkatëse bashkëngjitur, ndërsa tipi i derivacionit është përcaktuar mbi bazën e disa faktorëve, ku ndër më tërëndësishmit janë kushtet e terrenit (trasesë ku kalon) dhe kushtet gjeologjike. Të gjitha llogaritjet e kryera për kanalet e derivacioneve me Lug si dhe të derivacioneve me tubacion çeliku janë të shtjelluara në raportin e llogaritjeve hidraulike bashkëngjitur këtij materiali.

### ***Baseni i Presionit.***

Dy janë funksionet kryesore të basenit të presionit:

- Të parashikojë rregullimin e prurjes së turbinës sipas ngarkesës së kërkuar.
- Të parashikojë volumin e rrezervuar të ujit që të mbajë një nivel konstant të ujit në basen për kontrollin e operimit të turbinës

**Rregullimi i prurjes:** kapërderdhësi automatik i vendosur në muret e basenit, lehtësisht kryen rregullimin e prurjes së turbinës kur ngarkesa e sistemit ndryshon duke devijuar prurjen e tepërt mbi kapërderdhësin automatik dhe derdhjen e saj në lumë. Normalisht në këtë mënyrë operimi kërkohet që prurja në kanalën e shkarkimit të jetë më e madhe se prurja që kërkon Hec-i.



**Kontrolli i nivelit të ujit:** Për hidrocentrale të vegjël të lidhur me rrjetin elektrik është e nevojshme që energjia e dhënë nga turbina të jetë konstante dhe për këtë kërkohet që prurja të jetë e qëndrueshme dhe në nivel konstant, në këtë mënyrë maksimizohet energjia e dhënë nga uji. Kjo arihet me mënyrën e kontrollit dhe ruajtjes së nivelit të ujit në basen përmes së cilës rregullohet ngarkesa e turbinës me anë të barazimit të prurjes që vjen nga derivacioni me prurjen e kërkuar të turbinës.

Baseni i presionit amortizon dhe rregullon gabimet që mund të ndodhin në kuadrin e paisjeve të turbinës, dhe prurjen hyrëse nga kanali në basenin e presionit. Kjo kërkon që niveli i ujit në basen dhe kanalën e shkarkimit të matet dhe të transmetohet në kohë reale në paisjet elektronike komanduese të turbinës që masin dhe rregullojnë parametrat e ndryshëm të turbinës dhe sistemit në tërësi (përfshirë prurjen) e cila kërkon mbajtjen e nivelit të ujit në basen brenda niveleve të lejuara.

Për hidrocentralet e vegjël paisjet e kontrollit të ngarkesës së turbinës përfshihen në koston e turbinës, nga kjo kosto përjashtohet matësi i nivelit dhe paisja e transmetimit të të dhënave. Këto Hec-e zakonisht operojnë me nivel të lirë të ujit në basen, në mënyrë që ky nivel të mbahet poshtë kuotës së pragut të kapërderdhësit automatik. Kjo gjë nuk është problem gjatë perjudhës me prurje të mëdha kur prurja është shumë më e madhe se kërkesa e Hec-it. Sidoqoftë, gjatë perjudhës me prurje të pakta kur prurja e Hec-it është më e madhe se prurja e lumit, është e nevojshme të rregullohet the balanca e ngarkesës në limitin e prurjes së Hec-it, me siguri 90% të prurjes së lumit.

Përveç këtij funksioni, në raste të tjera baseni presionit kryen dhe funksione si: shpërndarjen e ujit nëpër tubacionet e tjera kur numri i tubacionit të turbinave është më i madh se një, shkarkimin e ujit kur nxirren nga puna pjesërisht ose plotësisht nga puna agregatet e hidrocentralit, shkarkimin e ujrave të tepërta që mund të hyjnë në basen, largimin e materialit të ngurtë që depozitohet përpara hyrjes së tubacionit, largimin e trupave notues që mund të sillen nga derivacioni etj.

Baseni i Presionit do të ndërtohet në fund të derivacionit në shpatin e malit përballë lagjes Lenaj të fshatit Val. Baseni do të shërbejë si hyrje e tubacionit të turbinave. Ai do të ketë një seksion drejkëndësh me përmasa  $H = 5.0 \times 3.5\text{m}$  me gjatësi 18 m. Tabani i basenit sht pranuar rreth 2.68 m i thellë që rakordohet me kanalën e derivacionit në planin horizontal dhe atë vertikal me formë hidraulikisht të pershtatshme. Thellessia e basenit është llogaritur bazuar në kushtin që uji të futet në tubacionin e turbinave pa krijuar shtjella. Në figurat 10.8 dhe 10.9 janë praqitur korografia e pjesë fundore të derivacionit, baseni i presionit dhe tubacioni i turbinave si dhe detaje të basenit.




Ne anen e majte te basenit parashikohet te ndertohej edhe nje shkarkues per devijimin e ujerave ne rastet kur turbinat nuk dote jene ne pune. Ujerat e shakruar dote devijohen nepermjet nje tubacioni ne procken mete afert nepermjet nje tubacioni celiku i cili parashikohet te tresohet paralel me tubacionin e turbinave. Konstruksioni i basenit është planifikuar të jetë beton arme. Tubacioni i turbinave eshte përpjendikular me aksin e basenit dhe pajiset me një zgar në hyrje dhe me nje porte për manovrimin e ujit me përmasa 0.4 x 0.4 m. Në fund të basenit do të vendoset edhe një tubacion 0 400 mm i paisur me një saracineskë për boshatishjen e basenit në raste kontrolli e avarie. Ky tubacion lidhet me tubacionin e shkarkuesit te pershkruar me lart. Për ndërtimin e këtij objekti do te sherbeje rruga qe do te ndertohej paralel me derivacioni

**Tubacioni dhe Turbinat**

Dimensioni i tubacionit të turbinave është bërë me formulën e diametrit ekonomikduke e kontrolluar për kushtet e grushtit hidraulik. Eshte trajtuar percaktimi i numrit te tubacioneve paralel me percaktimin e numrit te turbinave pra per nje dhe dy tubacione dhe ka rezultuar se varianti me optimal rezulton ai me nje tubacion turbinash me diameter sipas llogaritjeve  $DN = 400mm$ . Bazuar ne presionet qe krijohen ne kete tubacion,te rendit 50atm, eshte pranuar qe tubacioni te ndertohej ne dy pjese me diameter te njellojte por me trashesi paret te ndryshem.

Sipas standartit nderkombetar eshte zgjedhur diametri  $DN = 400/10$  dhe 16mm. Gjatesia totale e tubacionit eshte 1200m. Ne figure eshte paraqitur nje prerje gjatesore e trasese se tubacionit sipas rruges me te shkurter ndermjet Basenit te presionit dhe nderteses se centralit. Per kushtet konkrete ku kalon ky tubacion, rezulton qe ne pjesen e pare terreni formon nje grope gje e cila do te kerkonte qe tubi te kishte nje pjese te ngritur ku mund te grumbullohej ajer e per pasoj te shregullonte regjimin e levizjes se ujit ne te. Per t’iu shmangur ketij fenomeni negativ, eshte parashikuar qe tubacioni te futet ne nje tunel me nje gjatesi rreth 150m.





Per te percaktuar tipin e turbins jane perdorur rekomandimet e prodhuesve te ndryshem. Per karakteristikat e hidrocentralit "Shini" me prurje  $Q=0.5\text{m}^3/\text{s}$  dhe renie 500 m rezulton qe turbina te jete e tipit PELTON me aks horizontal. Duke patur synimin ( arrihet nje shfrytezim sa me i plote i rrjedhjes ujore dhe per te shmangur nderprerjet e plota te punes gjate ndonje remonti te pjeseshem, eshte pranuar qe t montohen dy turbina me prurje  $0.25\text{ m}^3/\text{s}$  secila. Edhe per kte rast tipi i turbines rezulton te jete PELTON me aks Horizontal.



### *Ndertesa e centralit*

Godina e Centralit eshte parashikuar te ndertohet ne anen e majte te kanalit te derivacionit te HEC "Stavec-1" (588-437m) duke i shkarkuar ujerat direkt ne kanaln e derivacionit te ketij hidrocentrali. Eshte pranuar nje prurje e njejte llogaritese e hidrocentralit  $0.5\text{m}^3/\text{s}$  sa prurja 100 diteshe e cila perkon edhe me prurjen mesatare te dhene ne studimin hidrologjik. Fuqia e vendosur po ashtu e njejte 2000kW. Pozicioni i nderteses eshte zgjedhur ne anen e majte te shtratit te lumit Mat duke parashikuar qe nje pjese e saj t futet ne skarpaten e shpatit. Kuota e dyshemese se nderteses do te varet nga parametrat hidraulike te vepres se marrjes se Kanalit te Derivacionit te hidrocentralit "Stavec-1" ne te cilin do te derdhen ujerat e HEC "Shini".




Ne ket faze te studimit kuota e dyshemese se centralit eshte pranuar 582.6m dhe aksi i turbines ne kuoten 583.0m. E gjykuar nga pikpamja gjeologo inxhinierike ndertesa inkastrohet ne shkemb gelqerore relativisht te fort. Ne planimetri ajo eshte kompozuar me tre seksione, dy per turbinat dhe nje shesh montimi. Ndertesa e centralit do te jete siperfaqesore me nje siperfaqe ne plan rreth  $270\text{ m}^2$  ( $10.0 \times 27.0\text{ m}$ ), lartesi 7.4 m, e paisur me dhome komande, shesh montimi, oficine e zyra. Gjithashtu do te paiset edhe me nje vinc-ure me kapacitet 10 ton (saktesohet me saktesimin e turbines). Pas daljes nga ndertesa e centralit uji derdhet direkt ne kanaln e derivacionit te HEC "Stavec-1", ose ne raste te vecanta do te krijohet mundesia qe

ujerat te derdhen direkt ne lumin Mat, nese derivacioni i Stavec-I nuk do te jete ne pune. Per futjen ne ndertese te centralit do te shfrytezohet rruga e sherbimit te hidrocentralit "Stavec\_1". Ne hyrje te ndrteses do te ndertohet edhe sheshi i transformatoreve per lidhjen e hidrocentralit me sistemin energjistik duke shrytezuar te njeten linje te HEC "Peshku".



### Lidhja e hidrocentralit me rrjetin energjetik.

Lidhja me rrjetin elektrik ekzistues per HEC-in eshte trajtuar hollesisht dhe jepet si studim i vecante bashkengjitur dosjes se Studimit te Projektit te Zbatimit te HEC-it "Shini". Lidhja e HEC "Shini" me sistemin elektroenergjetik do te behet me linje kablore me tension 35 kV te lidhur me HEC Peshku". Gjatesia e pergjithshme e linjes kablore do te jete 340 m. Me poshte jepet Planimetria e linjes kablore 35 kV te HEC Shini"



### Problemet mjedisore.

Problemet kryesore mjedisore, që potencialisht mund të lindin nga realizimi i këtij projekti, i cili synon të ndërtojë një Hec ndahet në dy faza kryesore:


- Gjatë fazës ndërtimore të objektit, dhe
- Pas vënies në funksionim të objektit

Nisur nga shqyrtimi i secilës fazë, është e qartë se do të kryhen ndërhyrje dhe aktivitete që do të krijojnë ndikime mjedisore të ndryshme. Ky raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis ka për qëllim që të evidentojë aspektet kryesore të ndikimeve të mundshme në mjedis dhe të propozojë masat zbutëse të nevojshme për të ulur në maksimumin e duhur efektet negative.



***Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet projekti, shoqëruar edhe me fotografi;***

Formacionet gjeologjike dhe tokësore që përbejnë pellgun ujembledhës janë mesatarisht të pershkueshem dhe po ashtu të gerryeshem. Në përgjithësi, pellgu ujembledhës i perroit të Bizes është i veshur me bimesi pyjore, vetëm në pjesën ku perroi hyn në grykën e Valit rreth 3.4 km është me bimesi të rrallë. Në lidhje të ngushtë të elementit klimatik tokësor, veshja bimore paraqitet me zonalitet vertikal të dukshëm. Veshja bimore e zonës në studim përbehet nga brezi i ahut dhe haloreve që shtrihen deri në kuotën 1600 - 1700m. Në katin e haloreve ndikimi i pyllit në rrjedhën ujore ndihet gjatë gjithë vitit. Në pellgun ujembledhës të Bizes shtrihen tokat e murrme pyjore që janë formuar mbi shkëmbinjtë të llojeve të ndryshëm.



### ***Informacion për pranin e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;***

Te dhenat e meposhtme jane marre nga studimi hidrologjik i bere per perroin e Bizes ne kuader te hartimit te projektit per shfrytezimin hidroenergjitik ndermjet kuotave 1203 deri ne derdhje te tij ne lumin Mat ne kuoten 583m. Studimi hidrologjik eshte pjese e dosjes se dorezuar per marrjen me koncesion te ketij objekti te titulluar HEC SHINI Sipas ndarjes gjeografike te vendit tone zona ne studim ben pjese ne krahinen Malore Qendrore pjese veriore e saj (Malesia e Martaneshit). Perroi i Bizes eshte dege e lumit Mat dhe derdhet ne kete lume npermjet grykes se Valit ne rruge nentokesore ne bregun e majte te lumit Mat Perroi i Bizes kufizohet nga veriu me pellgun e perroit te Xixullit -- dege e rendesishme ne pjesen e sipërme te lumit Mat. Vija ujendarese kalon ne malin e zones se Martaneshit (+1846m m.n.d.) dhe qafen e Himes (+1460m m.n.d). Ne lindje kufizohet me pjesen e sipërme te pellgut ujembledhes te perroit te Xixlles dhe te perroit te Pervalles dhe malin me kuote +1517m mn.d. Ne jug kufizohet me pjesen e sipërme te pellgut ujembledhes te perroit te Pervalles, dege kryesore e lumit te Rrapunit qe derdhet ne lumin Shkumbin. Ne perendim perroi i Bizes kufizohet me pjesen e sipërme te pellgut ujembledhes te lumit Erzen -- fillon nga qafa e Rinasit qafa e Monumentit dhe me malin e Spones (+1617m m.n.d.) Lugina e perroit te Bizes fillon nga kuota +1460m m.n.d. nga qafa e Himes dhe zbret ne fushen e Bizes ne kuoten +1200m m.n.d., ajo eshte ne forme gjatesore. Perroi i Kaprollit qe zbret nga lindja e pellgut ujembledhes te perroit te Bizes dhe perroi i Bizes qe zbret nga jugu pellgu ujembledhes nga mali Sukes (+1542), zbresin ne fushen e Bizes me kuote afersisht +1200 m m.n.d. Fusha e Bizes giendet ne skajin jug-lindor te malit me Gropa dhe mund te perfshihet edhe ne te, por me e arsyeshme eshte te studiohet me Martaneshin. Ajo eshte 2.5 km e giate dhe 2 km e gjere dhe ka nje sipërfaqe prej 3.7 km. Per nga gieneza eshte nje grope karstike e formuar ne nje strukture sinklinale dytesore ne kontakt me flishet. Ne pergjithesi ka nje fund te rregullt e te sheshte, sidomos giysma jugore. Prania e tokave te zeza si dhe kushtet e veeanta topografike te fushes se Bizes te bejne te mendosh se dikur, fundi i saj te jete zene nga ndonje liqen karstik i cili me vone u zbraz nepermjet grykes se Valit. Pjesa me e madhe e pellgut ujembledhes perbehet nga formacione karbonike flishore, gelqerore, jane te karstezuar -dhe konglomeratesh argiila ranore, mergele dhe depozitime flishoidale..

### ***Të dhëna për mjedisin egzistues të zonës ku zbatohet projekti.***

#### **Pozicioni,relievi**

Veprat e hidrocentralit "SHINI jane brenda pellgut ujembledbes te lumit Mat ne zonen midis fshatit Peshk dhe Bizes.Perroi i Bizes ose perroi i Valit eshte dega e lumit Mat ne krabinen e Martaneshit.Veprat e hidrocentralit jane pergjate kurizores malore qe ndan luginen e perroit te Valit me luginen e perroit te Xixulles. Relievi eshte malor me kuoten me te larte te zones se veprave 1846 m e malit Noi Madh, ne afërsi te shpelles karstike te Valit, rreth 1600 m sipas drejtimit verior.Ne shpatet e kanalit te derivacionit dhe te tubacionit te turbinave,relieve eshte me pjerresi te madhe,vecanerisht ne shpatin e tubacionit te turbinave.

## Gieomorfologjia gjeologjia.

Makroformat e relievit te zones se ndertimit te hidrocentralit "SHINI", jane me origjine strukturore-erozionale dhe litologjike. Te gjitha veprat e hidrocentralit dote ndertohen mbi shkembijte gelqerore me megalodonte te markes gjeologjike Triasik I siperme-Jurasik I poshtem (Ts-J). Dallohet ne zonen jugore te trojeve te hidrocentralit ngritja strukturore e malit Noi Madh,ndersa ne zonen qendrore eshte rrafshi I erozionali strukturor I fshatit Peshk(Giricaj).Ne kete rrafsh erozional jane te zhvilluar mikroformat karstike me kavitacione jot e thella me mbulesa te argjilave te kuqerremta,tipike per fushat karstike mbi shkembijte gelqerore.Gelqeroret me megaladente triasiko-junke jane shtrese e trashe, me structure kristaline te imet dhe pelitike. Jane me ngjyre te bardhe qumeshti deri te perhimet.Shtresezimi eshte subhorizontal, vecanerisht ne shpatin e majte te lugines se lumit Mat. Nje dukuri shume e vecante karstike ne kete zone eshte shpella e Valit, ku futen dhe vazhdojne rrjedhen ujerat e perroit te Bizes ( rrjedhje e siperme e perroit te Valit).

## Hidrogjeologjia.

Kushtet hidrogjeologjike te basenit ujembledhes te perroit te Bizes (rrjedha e siperme e perroit te Valit ), kane ndikim te rëndesishem ne parametrat e hidrocentralit, vecanerisht per studimin hidrogjeologjik te vepres. Eshte shume e rëndesishme te thuhet qe shtrati I perroit te Bizes dhe e perroit te Valit nuk jane haze drenimi per ujerat nentokesore te shpateve te basenit ujembledhes perkates. Pasqyra statike e ujerave nentokesore eshte ne kuota mete ulta nga kuotat e shtratit te perroit, vecanerisht ne zonat me shkembij gelqerore. Ka mundesi qe edhe ne rrafshin strukturor-litologjik midis Bizes dhe shpelles se Valit, qe perbehet kryesisht nga flirke alevrolite,(foto 3). Shtrati I perroit nuk eshte haze drenimi per ujerat e rrjedhjeve siperfaqesore. Per keto arsye ne gryken gelqerore para hyrjes se shpelles se Valit nuk duhet te ndertohet dige e larte meqenese ka keto kushte hidrogjeologjike te vecanta. Nga pikepamja hidrogjeologjike, shkembinjte gelqerore jane ujembajtes dhe me kapacitete te mesme dhe te larta ujedhenieje.Gjithe burimet e medha te ujit ne Shqiperi jane me origjine karstike

## Sizmika.

Trojet e veprave te hidrocentralit "SHINI dhe te gjithe zones se Martaneshit jane me intensitet te lekundjeve sizmike 8 balle( LLSK-1964),sipas Hartes te Rajonalizimit Sizmik te Shqiperise ne vitin 1980. Ndersa lidhur me reagimin sizmik,trojet e veprave te hidrocentralit jane te kategorise se dyte megjithese jane troje shkembore. Ne kushtet e tunelit te derivacionit dhe te veprave te tjera ne shpate te pjerreta ka problematike te stabilitetit . Si rrjedhoje koeficienti I sizmicitetit sugjerohet nga autoret te merret  $K_e=0,22$  (KTP-89)

## Vecorite Hidrologjike.

Pasurite ujore te pellgut ujembledhes te perroit te Bizes jane te favorizuara nga kushtet klimatike, tiparet e relievit dhe gjeologjia e tij. Perroi eshte dege e lumit Mat, qe derdhet ne kete lume nepermjet grykes se Valit qe eshte nje lugine tipike karstike te Bizes afersisht ku eshte dhe aksi i studimit konkret (vepra e marrjes se ujit per H/c) ne lartesi afersisht +1200m

m.n.d. Gjatesia e grykes se Valit eshte  $L = 16\text{km}$ , ka natyra gati te njejte, shpate vertikale dhe fund te ngushte, te sheshte e te thate. Deri tek gryka e Valit ekzistojne rrjedhje ujore siperfaqesore te ardhura nga pellgu ujembledhes i perroit te Bizes te cilet aty zhduken perfundimisht per te dale perseri ne sektorin e lumit Mat ndermjet fshatrave Peshk dhe Blishte. Perroi i Bizes ka nje siperfaqe ujembledhese prej  $F = 26.2\text{ km}$ , giatesi te shtratit kryesor te perroit  $7.50\text{ km}$ , dhe nje pjerresi mesatare te shtratit kryesor  $i\% = 53$ . Pellgu ujembledhes i perroit te Bizes fillimet e tij i ka tek qafa e Himes (+1460m m.n.d.) perroi mbasi zbret ne kuoten 1200m, merr drejtim per nga perendimi dhe para se te futet ne gryken e Valin, ne bregun e majte merr ujerat e perroit te Sukes (+1542m m.n.d.) dhe dy deget bashkohen ne fshatin Buze para futjes se perroit te Bizes ne gryken e Valit. Ne perroit Bize, dega e majte para se te bashkohet me degen qe vjen nga lindja, ne vitin 1977 eshte ndertuar nje rezervuar ujites me kapacitet volum  $V=850.000\text{ m}^3$  dhe siperfaqe te pasqyres se ujit  $S=0.12\text{ km}$ , siperfaqe e pellgut ujembledhes te rezervuarit artificial eshte rreth  $3.5\text{ km}$ . Perroi i Bizes ne te dy brigjet e tij mbledh ujerat e nje seri perroskash qe furnizohen nga malet per rreth pellgut ujembledhes, bregu i majte eshte me teper i furnizuar nga ujerat e shiut dhe bores se shkrire. Hidrografia e perroit te Bizes perbehet nga rrjedha ujore (perroska) te pjerrta qe tregojne orografine (fushen e pershkrimet malor te terrenit dhe jane rrjedhje me uje te rrembyeshem ne dimer qe zbresin ne fushen e Bizes (perroi i Bizes). Konfiguracioni orografik i zones ne studim paraqitet krejtesisht malor dhe i rrethuar me vargmale me lugina shpesh here te thella dhe me rrepara. Ne kete konfiguracion, karakteristikat kryesore morfometrike te pellgut ujembledhes ne vepren e marrjes se ujit per H/C kane rezultuar si me poshte: siperfaqja e pellgut ujembledhes  $V.M. F = 23.55\text{ km}$ . (Eshte zbritur siperfaqja e pellgut ujembledhes te rezervuarit) Gjatesia e aksit (trungut kryesor)  $L = 7.5\text{ km}$ . Pjerresia mesatare e shtratit te perroit  $i\% = 53$ . Llogaritjet e karakteristikave morfometrike u bene mbi bazen e hartave 1:25000.

## Rrjedhja ujore

Ne perroit e Bizes nuk ka patur matje te rregullta hidrometrike as edhe ndonje vendmatje per vleresimin e sasise se ujit. Per rrjedhim per logaritjen e parametrave hidrologjike te ktij perroi eshte perdorur metoda e analogjise duke patur ne konsiderate gjithashtu edhe kushtet specifike te rajonit te Bizes. Si lum analog ne kete rast eshte marre lumi Mat ne vendmatjen e Klosit, qe ka nje seri te kenaqshme te dhenash. Specifika qe ka pellgu ujembledhes i perroit te Bizes eshte fakti qe ai paraqitet si njesi me vete, edhe perfshihet ne pellgun ujembledhes te Matit por edhe qendron si i shkeputur sepse rrjedha ujore nuk ka vazhdimesi. Ne kete kuader ndofta per kontributin per njesi te siperfaqes (moduli) mund te mos merret moduli i vendmatjes se Klosit qe eshte teper i larte. Ne keto kushte kemi marre per baze llogaritje metoden me ane te reshjeve atmosferike. Reshjet jane marre ato te vendmatjes meteorologjike te Bizes qe ndodhet ne pellgun e vete perroit. Kuota e kesaj vendmatje eshte rreth  $1200\text{ mm}$  qe eshte pothuaj sa vepra e marrjes, keshtu qe nuk mund te jete perfaqesuese per gjithë pellgun ujembledhes. Keshtu qe nga vlere  $1750\text{ mm}$  si sasi mesatare vjetore e pellgut ujembledhes te vepres se marrjes ka rezultuar vlere  $1848\text{ mm}$ , qe ka ardhur si rezultat i ndertimit te izohetave. Kjo vlere eshte e pranueshme po te kemi parasysh kuotat e kreshtave qe jane pergjithesisht mbi  $1550\text{ mm}$  mbi nivelin e detit, por qe shkojne ne kufijte  $1600-1850\text{ m}$ . Nga ana tjeter eshte bere edhe nje vleresim i siperfaqes gelqerore qe ka brenda pellgut ujembledhes per te cilen kemi konsideruar qe minimalisht gjysma e saj ( $3\text{ km}$ ) kontribuon per ujerat qe dalin jashte pellgut ujembledhes. Nga siperfaqja totale rezultuan  $6\text{ km}$  gelqeror dhe nga ajo qe u tha me siper siperfaqja totale mbetet  $20.1\text{ km}$ . Si koeficient rrjedhje eshte pranuar vlere prej  $0.43$  qe eshte nje vlere qe ka dale si rezultat te marrjes ne konsiderate te kushteve gjeologjike, veshjen bimore dhe morfometrine e pellgut ujembledhes. Ne baze te parametrave te mesiperperm dhe nga veprimet e



kryera ka rezultuar nje prurje mesatare per vepren e marrjes prej 0.504 m/s, me nje modul mesatar te rrjedhjes vjetore 25 l/s/km2. Per llogaritjen e prurjeve mesatare mujore te aksit te vepres se marrjes te perroit Bizës janë shfrytëzuar te dhenat per vendmatjen e Matit ne Klos duke i transformuar me ane te raportit qe ekziston ndermjet prurjeve mesatare vjetore respektive. Nga llogaritjet perkatese kane rezultuar prurjet mesatare mujore per aksin e vepres se marrjes qe jepen ne tabelen 6.2, prurjet mesatare me siguri te ndryshme (Tabela 6.3) dhe Kurba e Qendrueshmerise (tabela 6.4 dhe figura 6.3)

Tab. 6.2 Prurjet mesatare mujore, vepra e marrjes përroi i Bizës

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
0.640	0.713	0.698	0.905	0.797	0.324	0.179	0.144	0.156	0.252	0.491	0.748	0.504

Tab. 6.3 Prurjet vjetore me siguri të ndryshme, Vn prr Bizës

Siguria në %	1	2	5	10	25	50	75	90	95
Q m <sup>3</sup> /s	0.830	0.781	0.713	0.657	0.573	0.493	0.424	0.370	0.341

Tab. 6.4 Koordinatat e kurbave të qëndrueshmërisë, përroi i Bizës vepra e marrjes

Ditet	Q m <sup>3</sup> /s	Q 25%	Q 75%
365.0	0.022	0.025	0.019
365.0	0.031	0.036	0.026
364.7	0.044	0.05	0.038
360.8	0.076	0.09	0.07
336.4	0.109	0.13	0.09
289.2	0.153	0.18	0.13
236.7	0.218	0.25	0.19
181.1	0.328	0.38	0.28
143.1	0.437	0.51	0.38
100.7	0.616	0.72	0.53
83.0	0.699	0.81	0.60
55.1	0.874	1.02	0.75
22.5	1.31	1.52	1.13
6.1	2.18	2.54	1.88
2.6	3.06	3.56	2.63
0.9	4.37	5.08	3.76
0.0	11.5	13.4	9.9

### Prurjet Maksimale

Duke pasur parasysh sasine maksimale te reshjeve 24 oreshe dhe intensitetin per intervale te ndryshme kohe ne periudha te ndryshme perseritje, zona ne studim karakterizohet nga nje intensitet mesatar i reshjeve. Resh jet maksimale 24h ne Bize jepen ne tabelen 6.5.

Tab. 6.5 Reshjet më të mëdha 24 orëshe

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Bize	83	106	79	61	80	56	31	49	54	118	112	185	185

Per llogaritjen e prurjes maksimale ne rrymat ujore ne veprat e marrjes se ujit per H/c, ne mungese te te dhenave hidrometrike eshte zbatuar metoda e mirenjohur Racionale.

$$Q = 0.28 \times F \times \bar{I}_{mm/orë} \times \alpha \quad m^3/sek$$

ku:

- Q - prurja maksimale, m<sup>3</sup>/sek
- 0.28 - koeficient njësimi
- F - sipërfaqe ujëmbledhëse, km<sup>2</sup>
- $\bar{I}_{mm/orë}$  - intensitet në orë shprehur në mm në orë
- $\alpha$  - koeficienti i rrjedhjes që varet nga sipërfaqja e pellgut

Me metodën racionale, prurja maksimale e pikut të plotes është në veeanti ajo që gjenerohet nga një reshje me kohezgjatje të barabartë me kohën e bashkeardhjes në aksin e vepres së marrjes së ujit, që do të thote intervali i kohës që i duhet pikës së ujit të rënë në pikën hidraulikisht me të largët të pellgut ujëmbledhës për të mbërritur në aksin llogarites. Për të llogaritur kohën e bashkeardhjes është përdorur formula e Viparelit, nga e cila rezulton që koha e bashkeardhjes për pellgun që shqyrtohet është ndërmjet vlerave 1.5 deri në 2 ore. Prurjet maksimale me perseritje të ndryshme në përgjithësi llogariten në varesi të sasisë maksimale të reshjeve për të njëjtat periudha perseritje dhe për kohezgjatje të njëjta të shiut. Në mungesë të të dhënave për kohe të ndryshme zakonisht shfrytëzohen matjet e reshjeve maksimale 24 orëshe të cilat konvertohen me formulën:

$$h_{p,t} = H(t/24)^n$$

- $h_{p,t}$  = sasia e reshjeve me siguri p për intervalin t (orë)
- $H_p$  – sasia e reshjeve me siguri p për intervalin 24 ore
- H - treguesi reduktimit të reshjeve jepet në manual (botim i Institutit Hidrometeorologjik)

Duke bërë zëvendësimet e nevojshme në formulën “Racionale” janë llogaritur prurjet maksimale me siguri të ndryshme të paraqitura në tabelën 6.4

Tab. 6.4 Prurjet maksimale me siguri të ndryshme, Vm përroi i Bizës

Emërtimi	F km <sup>2</sup>	Siguri të ndryshme				
		1	2	5	10	20
Vepra e marrjes	23.55	116	104	92.8	81.2	69.6

***Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundëshme, negative në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë tokë dhe ajër;***

*Ndikimet ne mjedis gjate ndertimit te veprave te marrjes se ujit dhe godines se hidrocentralit.*

Per ndertimin e ketij hidrocentrali do te ndertohen keto vepra: do te realizohen germime, ndertim kanalesh, tunel, shtrim t tubacioneve, hapje galerie, perdorim te makinerive germuese dhe transportuese, etj. Pra, gjate kryerjes se ketyre operacioneve do te kete shperndarje te pluhurave ne sasira te vogla. Kjo sasi pluhuri nuk dote shperndahet pertej zones se punes dhe do te jete shume e perkohshme.

*Ndikimet ne mjedis gjate pergatitjes se veprave te marrjes dhe kalimit te ujit per ne hidrocentral.*

Ndikim ne mjedis ka dhe ndertimi i veprave hidrike te ketij objekti. Per shkak te punimeve te germimit do te kemi shperndarje te pluhurit ne sasira te vogla. Si ne rastin e mesiperm, pluhuri nuk do te shperndahet me larg se sa rrezja e punimit, p.sh. ne hapjen e kanalit pluhuri nuk do te shperndahet me shume se sa gjeresia e kanalit. Ne rastet kur do te kemi te bejme me transport te dherave te germuara per te eliminuar perhapjen e pluhurit gjate transportit te gjitha mjetet e transportit dote mbulohen.

*Ndikimet ne mjedis gjate largimit hapjes se kanalit dhe transportit te materialit si rrezultat i hapjes se kanalit, tunelit, linjes se shtrirjes se tubacionit etj*

Ndertimi i hidrocentralit "Shini", detyrimisht do te shoqerohet me germime, hapje traseje, tuneli etj.

*Natyrisht qe aktiviteti per ndertimin e objekteve te HEC-it do te shoqerohet me mbetje te ngurta, por keto mbetje nuk do te jene te demshme. Dherat qe do te dalin nga germimet e trasese se kanalit dhe rruges, pjeserisht do te sistemohen ne skarpaten e djathte duke i veshur ato me shtresa vegjetale pershtatje me mjedisin perreth. Pjesa tjeter do te depozitohet ne vende qe do te caktohen nga pushteti lokal. Po ashtu pergjat kanalit parashikohet te mbillen drure te ndryshem te cilet do te krijojne nje ansambel te pershtatshem me pyjet perreth. Shumica e materialeve te ngurta do te dalin nga germimi per hapjen e tunelit dhe nje pjese e vogel nga tubacionet e derivacionit dhe turbinave. Germimet qe dalin nga tuneli, (te cilat jane rreth 60000 m') do te perdoren kryesisht per rehabilitimin e rruges ekzistuese te fshatit ne ndihme te komunitetit te zones, rruge, e cila eshte e gjate rreth 9 km me nje gjeresi 4.0 m. Pjesa e mbetur e materialit do te depozitohet ne sheshet e dhena ne Planimetrine e dhene me poshte. Kjo sepse materialet e dala nga germimi i tunelit jane te nje cilesie te mire per t'u perdorur si materiale ndertimi dhe vete firma koncesionare ka interes te dyfishte per ti perdorur ato, si nga*



*ana financiare pasi ulin koston ashtu edhe nga ajo mjedisore, duke eliminuar ne maksimum mbetjet e ngurta.*

Gjithashtu, projekti merr ne konsiderate te gjitha masat e nevojshme, per te eliminuar ndikimet e mundshme negative qe krijohen gjate fazes se ndertimit dhe shfrytezimit ne mjedisin rrethues. Projekti parashikon sistemimin e inerteve, duke i ndare ne sipërfaqe dhe volume te tilla, duke respektuar Ligjin 111/2012 "Per Menaxhimin e Integruar te Burimeve Ujore", Neni 4 pika 8 i cili perkufizon bregun e lumit si me poshte:

*"Brigjet", rripat anesore te tokes pergjate deteve, liqeneve, rezervareve, lagunave dhe pellgjeve, si dhe pergjat rrjedhes s shtratit te lumenjve e perrenjve, qe, ne funksion te perdorimit, perfshijne te pakten dy zona:*

*a) me gjeresi 5 m ne drejtim normal me token nga brinja e sipërme e shtratit natyror ne brigjet e pjerreta dhe 20 m nga vija e nivelit maksimal t plotave me probabilitet perseritjeje, nje here ne 25 vjet, t ujit ne brigjet e sheshta, qe perdoret per qellime publike me dispozita te vecanta;*

*b) me gjeresi 100 m ne drejtim normal me token nga brinja e sipërme e shtratit natyror ne brigjet e pjerreta dhe 200 m nga vija e nivelit maksimal te plotave me probabilitet perseritjeje nje here ne 25 vjet te ujit ne brigjet e sheshta, ne te cilen edo veprimtari e zhvilluar percaktohet nga organet e administrimit a menaxhimin te burimeve ujore. Kufiri i ndarjes se bregut te pjerret me bregun e sheshte shte pjerresia 10 per qind ne drejtim normal me bregun.*

Per kushtet e relievit te ketij projekti brigjet jane te pjerreta (pjerresia > 10%). Bazuar ne kete fakt, sipërfaqet per hedhjen e mbeturinave jane zgjedhur ne menyre te tille qe tu pergjigjet normave te sipërpermendura. Keto distanca variojne nga 100 m deri ne 150 m, zonat me gropa do te mbushen, ndersa ne procka do te merren masa per ndertimin e pritave mbajtese me material rethanor (gure) qe materiali te mos reshqasi ne drejtim te lumit/perroit. Zona e depozitimeve jane perzgjedhur ne vende te zhveshura pa bimesi dhe ku materiali do te shtrohet me shtresa te ngjeshura e te sistemuara.

*Masat per rigjenerimin e sipërfaqes gjate dhe pas shfrytezimit konsistojne ne:*

Gjate dhe pas perfundimit te punimeve, sipërfaqja e shesheve te depozitimit te materialeve inerte do te mbulohet me shtrese vegjetale dhe do te mbillet me fare bari (lilolium ose fare bari nga bimët barishtore te zones si lloj trifolium), por edhe me peme autoktone kryesist halore. Kjo bimesi duke qene me sistem rrenjore xhufkore dote luaj rolin e stabilizuesit biologjik te mases se dheut ne fazen e pare te riaftesimit te tokes dhe fillimin e zhvillimit te proceseve fillestare te formimit te struktures se tokes dhe raportet ajer-uje te agregateve tokesore dhe poreve.

Me konkretisht keto masa dote konsistojne ne:

- *Krijimin e siperfaqes per mbjellje te reja e gjelberime*

*Duke qene se si pasoje e shfrytezimit do te krijohen gropa, kanale projekti parashikon qe te mbillen peme ne keto siperfaqe te lira, ne harmoni te plote me bimesine dhe pyjet perpara fillimit te punimeve te vepres.*

- *Sistemimin e materialit te mbuleses dhe sterileve qe dalin gjate ndertimit*

*Sistemimi i mbetjeve teknologjike do te behet ne sheshin qe do te krijohet ne faen e ndertimit dhe me pas kur te filloje sistemimi i skarpatave do te merret e do te depozitohet ne ane te shtratit te vepres per te realizuar krijimin e shtresave vegjetale e mbjelljen e pemeve per mbrojtjen nga erozioni i metejshem.*

- *Sistemimin e brigjeve anesore*

*Subjekti do te realizoje sistemimin dhe mirembajtjen e skarpateve te shkalleve ku aktualisht ai eshte i shkaktar nga ndertimi. Skarpatat do te mbushen me material steril, e do te hidhen dhera te mbulesa mbi to. Mbasi te jete lidhur toka do te filloje mbjellja e pemeve.*

- *Mirembajtja e siperfaqeve te mbjella*

*Ajo do te realizohet nga subjekti. Mund te ngrihen prita per te perforcuar mbrojtjen e pyjeve nga erozioni ne zonat rreth. Gjithashtu do te kujdeset per mbareshtimin e pemeve qe do te mbillen nga shoqeria dhe gjate fazes se shfrytezimit.*

*Ndikimet ne mjedis si rrezultat i sjelljes se materialeve te ndryshme per ndertimin e veprave hidroteknike te hidrocentralit.*

Proceset e ponës për ndertimin e veprave hidroteknike do të realizohen nga makineri e paisje të ndryshme duke filluar që nga germimi i dheut, hapja e kanaleve, hapja e galerive e deri në berjen e transportin e betonit si dhe derdhjen e tij. Gjithashtu do të! perdoren dhe mjete transporti për të transportuar materialet dhe produktet e germimit dhe betonin. Keto mjete do të rrisin trafikun si dhe nivelin e zhurmave.

*Vleresimi i efektivitetit të pritshëm të masve zbutese*

Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritshëm të parashikuar në projektin e ndertimit të hidrocentralit do të varet nga respektimi i të gjithë treguesve të përcaktuar.

Kontrulli i monitorimit dhe përmirësimi i vazhdueshëm sipas kushteve të shfrytëzimit të krijuar gjatë aktivitetit, do të eojë përfundimisht në përfitimin e pamjeve të parashikuara në projekt.

#### *Zhurmat*

Gjatë ndertimit të hidrocentralit "Shini" do të ketë angazhim të makinerive për punime të germimit, transportit të materialeve etj. Pamvaresisht se hidrocentrali do të ndertohej larg zonave të banuara, për të zbutur efektin e trafikut të ngarkuar dhe të zhurmave që shoqërojnë ato, si rrugë të perkohshme do të përdoren, kur të jete e mundur rrugët dytësore. Në projekt është parashikuar ndertimi i rrugëve ndihmëse. Transporti i materialeve, vecanerisht të ndertimit, në rrugët ekzistuese do të programohet duke patur si qëllim kryesor shmangien e shqetësimeve në trafikun lokal. Gjatë natës mjetet e transportit do të operojnë me shpejtësi të ulta dhe do të ndalohej përdorimi i borive.

#### *Ndikimet në ujrat sipërfaqësore.*

Zbatimi i këtij projekti nuk le shkas për ndotjen e ujrave rrjedhës sipërfaqësore nga ndotes të ndryshëm si karburante, lende helmuese, etj. Mjetet e transportit do të jenë të kontrolluara nga kontrulli teknik i organeve shtetërore, gjë që ben moslejimin e qarkullimit të mjetit me të meta teknike. Për rastet aksidentale të cilat mund të shoqërohen me derdhje të karburantit apo të vajit, sasia do të jete shumë e vogël dhe ato do të derdhen në toke. Për keto raste subjekti ka planifikuar një punonjës, i cili do të merret me grumbullimin e këtyre ndotsave dhe depozitimin e tyre në vendin e caktuar.

#### *Ndikimi në ujrat nëntokësore.*

Ndertimi i hidrocentralit "Shini" për nga vetë proceset e punës dhe materialet që përdoren nuk emeton lende helmuese, shkarkime të lengeta të ndotura, apo vajra e karburante të holluara të cilat të depertojnë në ujrat nëntokësore. Germimi i dheut, hapja e galerive apo kanaleve, betonimi dhe nderimi i sallës së turbinave si dhe vendosja e pajisjeve të makinerive të nevojshme nuk shoqërohet me shkarkime të elementeve ndotes si persë i takon tokës, ujë sipërfaqësor e nëntokësor dhe ajrit.

***Një përshkrim për shkarkimet e mundëshme në mjedis, të tilla si: ujrat e ndotur, gaze dhe pluhëra, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;***





***Trajtimi i ujerave te ndotur dhe largimi i mbetjeve***

Zona nuk ka fasilite te trajtimit te ujerave te ndotur apo heqjes se mbetjeve te ngurta. Ujrat e ndotur te fshatrave qe ndodhen prane, i derdhen ato ne trupin uJOR me te afert, gje e cila bie ndesh me parametrat e cilesise se ujerave te embel dhe per trajtimin e ujerave me qellim ruajtjen e tokes dhe ujerave siperfaqesore dhe nentokesore nga ndotja. Gjer ne kohën e ndërtimit të rrjetit të jashtëm të kanalizimit, ujërat e ndotur të dala nga objekte të veçuara apo zona të tëra të qendrave të banuara (në rastin tone të godinës së centralit) mund të mblidhen në gropa septike, nga të cilat, në kohë të caktuara largohen me mjete të ndryshme transporti (autobote etj) të autoritetit përkatës Ujësjiellës Kanalizime sh.a. E njejtja zgjidhje do te behet edhe ne kete rast.

***Ndërtimi i gropave septike.***

Në këto gropa lëndët organike që përmbajnë ujërat e zeza kanë aftësi të dekantojnë lehtë meqë shpejtësia e rrjedhjes së këtyre ujrave prodhon gaze me erë të rëndë dhe zvogëlon vëllimin e tij. Kështu një gropë septike përfaqëson një farë dekantuesi të mbyllur, tek i cili bëhet dekantimi i ujrave të ndotur dhe kalbëzimi i llumit të dekantuar. Gropat septike mund të kenë një, dy ose tri ndarje nëpër të cilat ujërat e ndotur kalojnë nga e para në të dytën e kështu me radhë. Në seksionin e parë, dekantimi është më i madh, prandaj edhe përmasat e tij merren më të mëdha se të seksioneve të tjera. Llumi, sidomos në të ndarën e parë, ngjeshet mirë dhe zvogëlon vëllimin 3-4 herë.

Lëndët në gjendje pezull notojnë në sipërfaqe dhe aty duke u tharë e duke u ngjeshur formojnë një farë cipe. Në mënyrë që ujërat e ndotur të hyjnë normalisht në gropë e të dalin prej saj pa u penguar nga kjo cipë e krijuar, tubat e hyrjes dhe të daljes, si dhe vrimat ndërmjet ndarjeve të gropës pajisen me tridegësh (pjesë T). Vrimat e lëna në muret ndarëse kanë përmasa (15x15)cm. Gropat septike ndërtohen me tulla, gurë, me beton monolit ose me element të parapërgatitur prej betoni. Për të mënjeluar dalje e gazeve e të erës së keqe, gropat septike, nga sipër soletës mbulohen me argjilë të përzier me zhavorr ose me skorje me një trashësi që luhatet midis 0.5 dhe 0.8m.

Në disa raste, kur pozicioni i gropës septike nuk prish ambientin higjieno-sanitar të truallit, gropat septike ndërtohen të filtrueshme, megjithatë në rastin e godinës së centralit ky rast nuk duhet zgjedhur në mënyrë kategorike, sepse godina do të pozicionohet pranë shtratit të përroitlumit çka do të sillte ndotje të saj. Këto gropa që mund të kenë formë të rrumbullakët ose drejtkëndëshe ndërtohen siç u përshkruan më lart, me gurë, me tulla, me beton ose butobeton. Në fund të gropës shtrohen disa shtresa me zhavorr me madhësi të kokrrizave 1 gjer në 10cm. Pjesa e poshtme e mureve të gropës mund të ndërtohet me vrima ose muratura mund të ndërtohet pa llaç në mënyrë që të dalin ujërat e filtruara

Nderkohë që gjatë zbatimit të projektit, për nevojat e punëtorëve, shoqëria sipërmarrëse do të vendosë pranë kantierit të ndërtimit kabina të banjove publike të lëvizshme në mënyrë që të mos ketë shkarkime në mjedis. Në mënyrë që investitori të mos ketë shpenzime të këtyre kabinave, për shkarkimin e tyre të herëpashershëm, gjatë fazes së ndërtimit të nënobjekteve, mund të ndërtojë gropën septike, me kapacitet më madh dhe të lidhë shkarkimet e këtyre

banjove direct me gropën dhe në momentin që ndërtohet godina e centralit, hiqen kabinat dhe bëhet e mundur lidhja e kanalizimeve të godinës me gropën septike, e cila do të shërbejë gjatë gjithë faze së operimit të hidrocentralit, në shërbim të nevojave jetësore të personelit të punësuar.

### ***Klasifikimi i mbetjeve, mbetjet e rrezikshme***

Bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.99, datë 18.2.2005 "Për Miratimin E Katalogut Shqiptar Të Klasifikimit Të Mbetjeve".

Bazuar ne klasifikimin e mbetjeve, gjate ndertimit te hidrocentralit do te kete kete mbetje nge ndertimet (përfshire dhera të gërmuara nga zona të kontaminuara). Mbetje te tille do te kete vetem gjate fazes se ndertimit te hec-it domethene do te kete volume dherash te germuara te cilat do te venddepozitohen ne nje siperfaqe te caktuar sipas planit te rehabilitimit.

Mbetje të rrezikshme jane mbetjet: "eksplozive", substancat dhe preparatet të cilat mund të shpërthejnë nën efektin e flakës ose të cilat janë më të ndjeshme nga goditja apo fërkimi dhe "oksiduese", substancat dhe preparatet të cilat kanë reaksione të fuqishme ekzotermioke kur bien në kontakt me substanca të tjera, veçanërisht me substanca të djegshme. "shumë të djegshme": mbetje vajrash dhe mbetje te karburanteve te lëngshme, te rrezikshme": substancat dhe preparatet, të cilat nëse thithen nëpërmjet frymëmarrjes, injektohen ose penetrojnë në lëkurë mund të shkaktojnë rrezik të kufizuar të shëndetit.

Per ndertimin e hec-it nuk nevojiten substanca te tilla, pra nuk do te kete asnje mbetje te rrezikshme ne territorin ku do te ndertohet hec-i.

Sipas VKM-se nr.99, datë 18.2.2005 "Për Miratimin E Katalogut Shqiptar Të Klasifikimit Të Mbetjeve". mbetjet qe do gjenerohen gjate ndertimit te Hec Shini jane specifikuar si mbetje nga ndertimet (përfshi dhera të gërmuara nga zona të kontaminuara).

Bazuar ne vendimin e KM nr. 371, datë 11.6.2014, "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre" ne rastin e ndertimit te hidrocentraleve nuk do te kete mbetje te tilla.

### ***Mbetjet e ngurta***

Gjatë punimeve të zbatimit të projektit do të kryhen punime betoni për veprat e marrjeve, për shuarjen e energjisë në dalje, për kanalet e derivacionit, për basenin e presionit, për ankera dhe blloqe mbështetës të tubacioneve të rënies së turbinave, për ankera blloqe mbështetës dhe mure anësore dhe mur rrethues i sallës me beton për mbrojtje nga përmbytjet.

Gjatë aktivitetit të punimeve do të ketë lëvizje të automjeteve, punime gërmimi të konsiderueshme dhe si pasojë zhvendosje të inerteve ose prishje të vegjetacionit pyjor, hapje të kanalit të derivacionit, punime ndërtimi muresh, beton arme, mbushje me zhavorr, etj.

### ***Pluhuri***

Ne kete kompleks do te jete prezent e ekzistenca e pluhurit, sepse do te kete operacione pune qe do te shkaktojne pluhura sic jane transporti i materialeve te ndertimit. Ambientet brenda dhe

jashte zones se projektit do te lagen me uji pas cdo procesi pune gjithashtu dhe gjate transportit te inerteve dhe do te jene te mbuluara ne raste te nevojshme .

### ***Trajtimi i vajrave te perdorur***

Sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 765, datë 7.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura” përfshin të gjitha vajrat lubrifikante, të lëngshme apo gjysmë të lëngshme, me bazë minerale a sintetike, të cilat janë kthyer në të pavlefshme për qëllimin për të cilin janë prodhuar, pasi janë përdorur nga çdo lloj motori, pajisjeje e makinerie që punon me to, si dhe nëse kanë skaduar në magazina apo pika shitjeje.

Vajrat e përdorura (VP) përfshijnë:

- vajrat e përdorura në motorët me djegie të brendshme;
- vajrat e përdorura të kutive të shpejtësive (grasot);
- vajrat e përdorura lubrifikante minerale;
- vajrat e përdorura hidraulike;
- mbetjet vajore nga depozitat;
- përzierjet vaj - ujë;
- emulsionet.

Gjate ndertimit te Hec-it nuk do te kete ndotje nga vajrat lubrifikante, të lëngshme apo gjysmë të lëngshme, me bazë minerale a sintetike, të cilat janë kthyer në të pavlefshme për qëllimin për të cilin janë prodhuar, pasi janë përdorur nga çdo lloj motori, pajisjeje e makinerie që punon me to, si dhe nëse kanë skaduar në magazina apo pika shitjeje. Nuk do te kete derdhje te vajrave te perdorur , të dëmshme në tokë, si dhe shkarkim te pakontrolluar te mbetjeve që rezultojnë nga përpunimi i tyre. Investitori qe ne fillimin e punimeve tregohet i gatshem me masat qe do te marri ne raste se do ndodhi ndonje rast i tille, i derdhjes se vajit te makinerive ne toke.

### ***Mbetjet inerte***

Sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”. Mbetjet inerte me mundesi ricikluese do te grumbullohen dhe do te dorëzohen tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, pra ne kompani ricikluese. Shoqeria investitore e cila kryen punime per ndertimin e hidrocentralit, do te ruajë, t'i transportojë dhe t'i dorëzojë mbetjet inerte në venddepozitimin e përkohshëm sipas përcaktimeve të vendimit nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave.

Venddepozitimi i mbetjeve nuk do te behet ne zonat e meposhtme:

- Zonat e mbrojtura, arkeologjike, turistike apo në çdo zonë që mbrohet me një akt normativ;
- Zonat në distancë 300 metra nga një pus furnizues me ujë dhe çdo burim tjetër ujqor;



- Zonat në distancë 100 metra nga një përrua, argjinaturë lumore, liqen, lum ose kompleks ligatinor;
- Zonat në distancë 300 metra nga një zonë e mbrojtur në përputhje me piken e pare.
- Mjetet teknologjike qe do transportojne mbetjet do te jene te pajisur me licensat e tipit III.2.B si detyrim i ligjit nr 10463,date: 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve” i ndryshuar.

### ***Menaxhimi i mbetjeve nga gomat e perdorura.***

V KM nr. 652, datë 14.9.2016, “Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura” nenkupton menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura, rregullat dhe kriteret që përfshijnë mbledhjen/grumbullimin, transportimin, ruajtjen/magazinimin dhe trajtimin e gomave të përdorura në mënyrë të tillë që të sigurohet mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe e mjedisit. Në kuptim të këtij vendimi me termat e mëposhtëm nënkuptohet: “Grumbullues”, personi që kryen grumbullimin e mbetjeve të gomave të përdorura. “Magazinues”, personi që kryen ruajtjen e përkohshme të mbetjeve. “Trajtues”, personi që kryen trajtimin e mbetjeve. Gjate ndertimit te Hec-it, gomat jashte perdorimit nuk do te digjen apo te hidhen por do te grumbullohen dhe transportohen nga shoqeria investitore dhe do te magazinohen ne ambiente te caktuara (shoqeri te licensuara per grumbullimin e tyre) dhe do te trajtohen si goma të përdorura në mënyrë të tillë që të sigurohet mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe e mjedisit perreth ku ndertohet Heci-i. I gjithë procesi i grumbullimit, transportimit dhe magazinimit do te behet sipas rregullave dhe procedurave te shoqerise se licensuar per grumbullimin e tyre.

### ***Baterite, akumulatorete dhe mbetjet e tyre***

Qellimi i V KM, Nr. 866, datë. 04.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre” është mbrojtja, ruajtja e përmirësimi i cilësisë së mjedisit, si dhe mbrojtja e shëndetit publik, përmes minimizimit të ndikimeve negative nga bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre. Gjate fazes se ndertimit te hidrocentralit nuk do te kete probleme dhe ndotje nga baterite dhe akumulatorete e tyre.

### ***Transferimi i mbetjeve jo te rrezikshme***

VKM, Nr. 229, datë .23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”. Dokumenti i transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme plotësohet për të gjitha hallkat që ndiqen për transferimin e mbetjeve që nga krijimi deri në destinacionin përfundimtar. Dokumenti i transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme plotësohet dhe nënshkruhet nga krijuesi i mbetjeve, grumbulluesi, transportuesi dhe pritësi që merr në dorëzim mbetjet. Per cdo transferim mbetjesh do mbahet nje dokumentacin sipas shtojces 1 te VKM-se, ne te cilen do te shenohet data perkatese, per llojin e mbetjes, volumet, gjendjen e tyre dhe pozicionin e venddepozitimit, etj.

### ***Informacion për kohëzgjatjen e mundëshme të ndikimeve negative të identifikuar;***

Aktiviteti i hidrocentralit ndahet ne dy faza kryesore

- Faza e ndertimit (per nje periudhe te caktuar sipas grafikut te punimeve, 48 muaj)
- Faza e operimit (sa jetegjatesia e Hidrocentralit).

Kohezgjatja e ndikimeve kryesore perkon me kohezgjatjen e rehabilitimit dhe ndertimit te veprave.

Kohezgjatja e rehabilitimit dhe ndertimit te vepres do te sipas grafikut te punimeve,48 muaj nga data e marrjes se lejes se ndertimit

Siperfaqja qe do te preket do te rehabilitohet paralel me kohen dhe fazen e rehabilitimit e ndertimit. Nga informacioni i grumbulluar me siper dhe analiza e tyre po bejme nje permbledhje ne menyre me te detajuar te vleresimit sasior te ndikimeve ne mjedis nga zbatimi i projektit, te cilat do te merren parasysh ne kete projekt dhe rezultatet jepen ne tabelen qe vijon. Tabela e identifikimit te ndikimeve ne mjedis te projektit dhe ceshtjet mjedisore qe trajtohen ne VNM.

Perputhja e Projektit me Planin e Rregullimit te Territorit dhe me Planet e Zhvillimit Ekonomik te Zones ku do te Zbatohet Projekti. Shoqeria investuese do te kete mbeshetjen nga shteti konform procedurave ligjore sepse shfrytezimi i burimeve hidrike per prodhimin e energjise elektrike perben perparesi. Me ndertimin dhe venien ne shfrytezim te ketyre veprave do te punesohen njezre te papune, dhe njekohesisht prodhimi i energjise elektrike do te lehtesoje dhe do te ndihmoje direkt ne zhvillimin ekonomik te zones dhe indirekt ne permiresimin e situates energjitike te vendit.

NR	Pyetje që konsiderohen në fazën e përzgjedhjes	Po/Jo	Cilat elemente te mjedisit ndikohen dhe si?	Do të jetë ndikimi domethënës?Pse?
1	Ndryshime të përkohshme ose të përhershme në përdorimin e tokës, mbulesën e tokës ose topografi duke përfshirë rritjen e intensitetit të përdorimit të tokës?	Po		JO, Do behen punime mbi siperfaqen e tokes per ndertimin e: Per Hec SHINI vepra e marrjes se ujit, dekantuesi, tubacioni i renies se turbinave, baseni i presionit dhe godina e Hec SHINI
2	Pastrimin e tokës ekzistuese, vegjetacionit dhe ndërtimeve ekzistuese	PO	Toka dhe flora	JO, sasia e pastrimit eshte e vogel. Projekti ka leverdi ekonomike.
3	Krijimin e përdorimeve të reja të tokës?	JO		
4	Investigime para fazës ndërtimore si shpime për	PO	Toka	Jo, jane sasi te Parendesishme

	marrjen e mostrave, provat e tokës, dheut?			
5	Punime ndërtimi?	PO	Toka	JO, jane siperfaqe te vogla qe do te rehabilitohen
6	Punime prishje?	JO		
7	Kantiere të perkohshme per ndërtim ose strehim për punëtorë?	PO	Toka	JO, eshte e perkohshme
8	Punime mbitokësore, struktura ose punime të tokës përfshirë struktura lineare, ekskavime, gërmime ose mbushje të tyre?	PO	Toka	JO, Do behen punime mbi siperfaqen e tokes per ndertimin e Hec. SHINI: vepra e marrjes se ujit, dekantuesi, tubacioni i renies se turbinave, baseni i presionit dhe godina e Hec SHINI
9	Punime nëntokësore duke përfshirë miniera apo tunele?	JO		Jo, tubacioni nen presion do mbulohet ne te gjithë gjatesine e tyre mbasi te ndertoht
10	Struktura bregdetare si diga, skela?	JO		
11	Mjedise për magazinimin e mallrave dhe Materialeve të ndryshme?	PO	Toka	JO, eshte i perkohshem. (Gjatë fazes së ndërtimit të objekteve)
12	Impiante për trajtimin ose depozitimin e mbetjeve të ngurta ose shkarkimeve të lëngëta?	JO		
13	Rrugë e re, trafik detar ose hekurudhor gjatë fazës së ndërtimit ose shfrytëzimit?.	PO	Toka	Ndërtim të rrugëve të reja ne ndihme te realizimit te veprave hidroteknike. Përmirësim i infrastrukturës së projektit
14	Rrugë e re, hekurudhore, ajrore,ujore ose infrastruktura të tjera transporti përfshirë dhe rrugë e stacione te reja	Jo		



	ose te alteruara, porte, aeroporte, etj?			
15	Mbyllje apo devijim i rrugëve ekzistuese ose i infrastrukturës që çon në ndryshime në lëvizjet e trafikut?	JO		
16	Linja ose tubacione të reja transferuese të transmetimit?	PO	Toka dhe mjedisi human	Do te vendoset, tubacioni i renies se turbinave per Hec SHINI
<b><i>A do të përdoren gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit të projektit burimet natyrore të tilla si toka, uji, Materiale ose energji, ndonjë nga burimet që janë të parinovueshme ose të kufizuara?</i></b>				
1	Tokë veçanërisht e varfër apo toka bujqësore?	PO	Asnje element	JO, jane siperfaqe te pakonsiderueshme
2	Uji?	PO	Asnje element	Eshte burim i rinovueshem
<b><i>A do të prodhohen mbeturina të ngurta nga projekti, gjatë ndërtimit, shfrytëzimit ose nxjerrjes jashtë funksionit?</i></b>				
1	Mbeturina dherash, zhavorri ose minierash?	PO	Toka dhe uji	Jo, sepse do të riciklohen përsëri dhe ndikimi negativ i tyre eshte i perkoheshem
2	Mbetje urbane (shtëpiake dhe /ose nga tregtia)	JO		
3	Mbetje te tjera të proceseve industriale?	JO		
4	Ujëra të zeza ose llumra të tjera nga trajtimet e shkarkimeve të lëngëta?	JO		
<b><i>A do të shkarkohen ndotës në ajër ose çdo substancë tjetër e rrezikshme toksike ose e dëmshme për shëndetin nga projekti?</i></b>				
1	Shkarkime nga djegiet e karburanteve fosile nga burime stacionare ose të lëvizshme?	PO	Ajri	JO, jane ne nivele te paperfillshme dhe vetem gjate kohes se punimeve per ndertimin e Hec-it.
2	Shkarkime nga proceset prodhuese?	JO		
3	Shkarkime nga aktivitetet e ndërtimit përfshi impiantet dhe pajisjet?	JO		

<b>A do shkaktojë projekti zhurma dhe vibracione ose emetim të dritës, energjisë termike ose rrezatim elektromagnetik?</b>				
1	Nga puna e pajisjeve si psh.motora,impiante ventilimi, thërmues guri?	PO	Zhurma e makinerive	JO, sepse do të ekzistojnë vetëm gjatë fazës së ndërtimit
2	Nga trafiku gjatë ndërtimit ose shfrytëzimit?	PO	Zhurma	JO, sepse do të ekzistojnë vetëm gjatë fazës së ndërtimit.
3	Nga burimet e rrezatimit elektromagnetik(merr në konsiderate efektet mbi pajisjet e ndjeshme në afërsi ashtu si dhe për njerëzit)?	JO		

Ndikimet ne mjedis te shkaktuara nga ndertimi i hec-it, te trajtuara ne ceshtjet e mesiperme do te ndodhin vetem gjate ndertimit te Hec “SHINI”. Gjate ndertimit te Hec-it te gjitha ndikimet do te jene nen kontroll nga shoqeria investitore dhe ne perfundim te ndertimit te hec-it do te behet rehabilitimi i zones ne harmoni me mjedisin perreth.

***Të dhëna për shtrirjen e mundëshme hapsinore të ndikimit negative në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendodhja e projektit, dhe vlerat ndërkufitare që përfshihen në të:***

***Hapesira ku do te ndertohet vepra, ndikimet negative.***

Ndikimi negativ ne kete siperfaqe do te jete kryesisht ne germimin e dherave per hapjen e themeleve te veprave. Nje perqindje e materialeve qe dalin nga germimet do te rifuten ne pune pasi do te sherbejn e si material mbushes per kanalet dhe pjeset anesore te mureve te veprave, ndersa pjesa tjeter do te hidhet brenda hapesires te rehabilitimit te vepres ne vende pa interes publik dhe ne gropa te cila kane nevojte per mbushje gje e cila do te konsultohet edhe me pushtetin lokal te zones.

**Hapesira jashte siperfaqes ku do te ndertohen veprat qe do kete ndikime negative.**

Jashte siperfaqes se ndertimit te vepres, ndikime negative do te kemi vetem ne zhurmat, ngritja e pluhurit dhe vibrimet te cilat i permendem dhe me siper per marrjen e masave te tyre. Ndikimi i tyre do te jete brenda normave te lejuar dhe oraret e punimeve do te zgjidhen ne menyre te tille qe te mos kete shqetesime per banoret e zones. Zonat e banuar (fshatrat) nga vendi i ndertimit te vepres kane nje largesi te konsiderueshme keshtu qe zhurmat ,vibrimet dhe pluhuri do te jene ne masa te paperfillshme Analiza e kryer ne kete raport ne lidhje me ndikimet e mundshme ne mjedis te projektit tregon se ato jane te kufizuara dhe pa pasoja te rëndesishme. Po keshtu edhe kohezgjatja e ndikimeve qe mund te konsiderohen te rëndesishme eshte e limituar. Ndertimi dhe venia ne shfrytezim e ketij hidrocentrali do te ndihmonte ne nje mase te konsiderueshme zgjidhjen e problemit te furnizimit me energji elektrike ne zone duke siguruar prodhimin e energjise se paster nga burime te rinovueshme.

Me poshte trajtohen ndikimet pozitive dhe negative te projektit ne te gjithë elementet specifike mjedisore (sipas metodologjise se lartpermendur) gjate fazes se ndertimit dhe shfrytezimit te Hec SHINI.

### ***Ndikimi i Projektit Gjate Fazes se Ndertimit***

Ndikimet i klasifikojme sipas fazave te zhvillimit te projektit dhe natyres se tyre dhe mund t'i ndajme:

- ndryshim peizazhi: nga germimet e tokes, nga ndertimi i vepres se marrjes, ndertimi i traseve te dekantuesit dhe basenit me beton dhe te tubacionit nen presion, godines te Hec SHINI .
- Ndryshime ne regjimin e ujrave.
- zhurma, pluhuri dhe gazrat djegese te motoreve te mjeteve te punes.
- zhvendosje e nje sasie te madhe zhavorri dhe dheu te cilet parashikohen te shfrytezohen.
- demtim i bimesise pyjore

### ***Ndikimi i Projektit Gjate Fazes se Shfrytezimit***

Ndikimet gjate fazes se shfrytezimit klasifikohen ne:

- zhurma e turbinave dhe gjeneratoreve gjate punes se hidrocentraleve
- probleme te erozioni.

Keto mendohet te zvogelohen me perfundimin e fazes se ndertimit me mbjellen e fidaneve dhe ruajtjen e brigjeve te perrenjve. Disa elemente te cilesise se jetes dhe mjedisit qe preken nga ndikimet e projektit paraqiten ne menyre me te detajuar me poshte. Punimet qe do te realizohen kryesisht gjate periudhes se zbatimit te projektit, vleresohet se do te shkaktojne ndikime ne mjedisin rrotull te cilat jane te domosdoshme te vleresohen ne kuadrin mbrojtjes se mjedisit.

***Mundësit e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësin e kthimit të mjedisit të ndikuar në sipërfaqe në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitim;***

PLANI PER REHABILITIMIN E MJEDISIT

#### 1.MBJELLJA E FIDANEVE TE RINJ

Duke gene se si pasoje e shfrytezimit do te krijohen gropa, kanale projekti parashikon qe te mbillen peme ne keto sipërfaqe te lira. Per kete subjekti parashikon te shpenzoje nga fitimet e saj. Perkujdesja e firmes per zhvillimin e bimesise do te vazhdoje edhe m bas mbjelljes.



## 2.SISTEMIMI I STERILEVE

Sistemimi i mbetjeve teknologjike sic theksohet me siper do te behet ne sheshin qe do te krijohet ne fazen e ndertimit dhe me pas kur te filloje sistemimi i skarpateve do te merret e do te depozitohet ne ane te shtratit te vepres per te realizuar kijimin e shtresave vegjetale e mbjedhjen e pemeve per mbrojtjen nga erozioni i metejshem.

## 3.MIREMBAJTJA E SIPERFAQEVE TE MBJELLA

Ajo do te realizohet nga subjekti. Mund te ngrihen prita per te perforcuar mbrojtjen e pyjeve nga erozioni ne zonat reth karieres. Gjithashtu do te kujdeset per mbareshtimin e pemeve qe do te mbillen nga shoqeria. Per kullimin e ujrave qe do te grumbullohen ne sheshin e depozitimit te sterileve do te hapet nje kanal per drenimin e ujrave jashte sheshit te depozitimit.

## 4.SISTEMIMI SKARPATEVE PARA E PAS SHFRYTEZIMIT

Subjekti ka per detyre e do te realizoje sistemimin e mirembajtjen e skarpateve te shkalleve ku aktualisht ai eshte i shkaktuar nga ndertimi. Skarpatet dote mbushen me material steril, e do te hidhen dhera te mbuleses mbi to. Mbasi te jete lidhur taka do te filloje mbjedhja e pemeve.

## 5. GJELBERIMI I MJEDISEVE RRETH GODINES SE HEc-it

*Krijimi dhe rikrijimi apo dendesimi i mbuleses se gjelbert apo gjelberimi i rrethinave te objekteve eshte ne funksion te rehabilitimit mjedisor te territorit, ku keto objekte qe ngrihen e ndryshojne mjedisin, ulin cilesine e tij prane ketyre objekteve. Ne funksion te rehabilitimit, peisazhit te ketij territori do te perfshihen ne Planin e Rehabilitimit:*

*Rigjelberimi i habitatit prane godines se hidrocentralit me bimesi autoktone dhe joautoktone, krijimi i nje siperfaqe te gjelbert qe te jete e sinkronizuar me ndertimin e godines dhe te mjedisit rrethues, gjithashtu krijimi i nje tapeti te gjelbert afer godines se kombinuar me drure dekorative te nje lartesisie te vogel dhe gjithmone te gjelbert. Keto punime synojne rehabilitimin e peisazhit, amortizimin e zhurmave, rritjen e qendrueshmerise mjedisore, etj. Rigjelberimi i habitatit me bimesi autoktone, prane vend-depozitimeve te inerteve, prane vepres se marrjes, basenit te presionit, tubacionit te presionit. Pjese e Planit te Rehabilitimit Mjedisor do te jete mbjellja e drureve pyjore rreth ketyre objekteve me nje rezistence karshi thatesires e ngrices per te mbrojtur nga erozioni dhe rritjen e jetegjatesise se ketyre veprave.*

## 6.RIGJELBERIMI I VATRA VE TE ERODUARA

*Territori ku do te ndertohet HEC-i dhe veprat inxhinierike, aktualisht paraqitet me shfaqje te erozionit me nje shkalle te larte intesiteti. Per te frenuar aktivitetin e erozionit dhe ne funksion te rehabilitimit mjedisor te territorit, i cili rezu/ton i perkeqesuar per shkaqe te trasheguara si prishjen e pyjeve duke i hapur toka te reja, ku eshte ne vazhdim shplarja e tokes aktive e dalja e shkembinjve ne siperfaqe, por dhe me nderhyrjet me punimet e parashikuara ne projektin e ndertimit te HEC-it do te perfshihen ne Planin e Rehabilitimit keto punime: Mbjellja e fidaneve pyjore ne vatrat e eroduara dhe ne vatrat ku mbulesa bimore eshte e degraduar dhe me drure te rralle ne sasite qe do te percaktohen ne baze te siperfaqes.*

## 7.MIREMBAJTJA E HABITATEVE

*Ne gjithë masat rehabilituese, perfshihen dhe mirembajtja e habitatit. Konkretizimi ne terren i ketyre masave parasheh uljen mbi rritjen dhe zhvillimin e gjallesave (flora dhe fauna) qe nenkupton ndalimin e vjeljes se prodhimeve te dyta pyjore dhe kufizimin ne maksimum te prerjeve te ketyre siperfaqeve pyjore ku do te ndertohet **HEC-i**, ndalimi ne menyre kategorike i prerjeve te pyjeve ekzistuese. Kjo do te arrihet duke marre masa paraprake si gjate shfrytezimit ashtu edhe gjate ndertimit duke bashkepunuar me organet pyjore si dhe pushtetin lokal si dhe vendosjen e shenjave paralajmeruese dhe postbllloqe per moshyrjen e mjeteve dhe personave qe shkaktojne demtime ne mjedis.*

### **Masat e mundëshme për shmangjen dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;**

#### **Ndikimet**

Aktiviteti qe parashikohet te realizohet ka te beje me ndergjegjesimin dhe sensibilizimin e fermerit (perdoruesit) per rendesine qe ka pyllzimi i siperfaqeve pyjore.

Mendojme se projekti qe kemi hartuar eshte mjaft inovativ dhe paraqet mjaft interes per komunitetin i cili ne dite pyjesh do te njihet:

- Me rendesine e kryerjes se punimeve te pyllzimit te siperfaqeve pyjore.
- Me teknologjine ne punimet e pyllzimit.
- Me efektivitetin e punimeve te pyllzimit.
- Ngritjen e kapaciteteve te komunitetit per menaxhimin e qendrueshem te pyjeve e kullotave.
- Ndergjegjesimi i fermereve per domosdoshmerine e kryerjes se punimeve te tilla ne funksion te shtimit te efekteve pozitive,shtojme ketu edhe mundesine e vjeljes se nje prodhimi cilesor te frutave te lajthise per eksport,duke rritur te ardhurat e tyre dhe duke ndikuar drejtperdrejte ne gjithë aktivitetin e tyre jetesor.

- Do të nxitet transferimi i kësaj eksperience në komunitetin për rreth e më gjere.
- Nga ky projekt do të përfitojë direkt përdoruesit e pyjeve në këto sipërfaqe që realizohet ky projekt.

### ***Mjedisor***

- Rruajtja e zhvillimi i biodiversitetit, sekuestrimi i karbonit sipas marrëveshjes së Kiotos në kuadrin evropian (nga rruajtja e tokës dhe instalimi i bimesise natyrore e të kultivuar).

### ***Ekonomike***

- Përfitimet shkojnë më larg se sa vetë komuniteti, dhe konkretisht ndikimi në GDP. Social Kulturore - Sigurimi i nevojave të komunitetit, punësimi etj.

### ***Vlerësimi, monitorimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të mbjella***

Ajo do të realizohet nga subjekti. Mund të ngrihen prita për të forcuar mbrojtjen e pyjeve nga erozioni në zonat rreth sheshit të nenobjekteve. Gjithashtu do të kujdeset për mbareshtrimin e pemëve që do të mbillen nga shoqëria. Për kullimin e ujërave që do të grumbullohen në sheshin e depozitimit të sterileve do të hapet kanale për drenimin e ujërave jashtë sheshit të depozitimit. Pas zbatimit të plote të projektit do të bëhet vlerësimi i efekteve të punimeve të kryera në grumbullin pyjor nëpërmjet monitorimit, duke mbajtur shënime periodike. Për vijimesinë e procesit objekti do të mbahet nën kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet vezhgimeve të herpashëshme.

### ***Faktoret bashkëpërues e mbështetës në zbatimin e projektit do të:***

- Informohen me evidencat periodike duke cilësuar për qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e projektit.
- Do të bëhet monitorimi i të ardhurave (qofshin këto direkte apo indirekte) të përfituara nga implementimi i projektit, duke bërë listimin e përfitimeve dhe vlerën e tyre

### ***Masat rehabilituese në rast ndotje dhe demtimi të mjedisit***

Shoqëria investuese që do të ndërtojë dhe shfrytëzojë veprat hidroenergjitike merr në konsideratë ndikimin në mjedis dhe do të marrë të gjitha masat për zbutjen e ndikimeve të mundshme negative. Në rast ndotje aksidentale, shoqëria merr përsipër dëmet e ndikimit të shkaktuar në mjedis. Ndërtimi i Hec Shini për prodhimin e energjisë elektrike mund të demtojë mjedisin si rrjedhojë e:

### ***Dëmtimeve (ose aksidenteve) të veprave të vecanta inxhinierike për të cilat do të merren masat e duhura për rehabilitimin e tyre.***

- kryerjes së punimeve restauruese në pjesën e demtuar.
- ndonjë avari gjatë procesit të punës
- Instalimi i vepres së marrjes me kapacitet marrës të ujit më të madh se atë të llogaritur dhe mbyllja e portës ekologjike.

### ***Plani i Monitorimit dhe Menaxhimit te Mjedisit***

Projekti ne fjale ka vlera te medha inxhinierike dhe perfitime te konsiderueshme ekonomike.

Per tipin e aktivitetit qe kerkon te ndermarre shoqeria, ne fazen e shfrytezimit, hidrocentrale te tilla mund te punojne shume mire ne kushtet e mikrosistemit, duke u bere nje garanci energjitike rezerve per zonen. Nevojitet qe te kryhet bashkepunim me institucione te specializuara, per ruajtjen e parametrave hidroenergjitike pa prishur ekuilibrat mjedisore pasi kemi te bejme me ndertim dhe perdorim te resurseve hidrike.

Projekti ka nevoje per monitorim mjedisor rigoroz nga organet kompetente mbikqyrese ne kuadrin e mbajtjes nen kontroll te parametrave mjedisor si dhe te veprave te vecanta inxhinierike si vepra e marrjes se ujit, linjat e tubacionit nen presion, etj. Pas ndertimit te hec-it duhet te mbahet nen mbykqyrje rehabilitimi i zonave te prekura nga punimet. Monitorimi i ndikimit ne mjedis duhet te kryhet nga inspektore te specializuar per mbrojtjen e mjedisit, te kontrollit te ujrave, sherbimit pyjor, pushtetit vendor dhe qendror, MTM – ja, AKM - ja dhe ARM – ja

### ***Ripërtëritja e mjedisit***

Ndërtimi i nen objekteve te HEC –it do të dëmtojë bimësinë e egër që rritet në atë zonë. Në marrëveshje të plotë me pronarët përkatës, sipas planit te rehabilitimit te parashikuar dhe hartuar nga specialistet qe u permend me siper, sipërfaqet rreth sheshit të punimeve do të sistemohen duke marrë masa për ta ruajtur dhe mbrojtur nga erozioni.

### ***Ky plan përfshin:***

- Minimizimin e lëvizjes së dheut
- Mbjelljen me bimësi në zonat ku parashikohet të ketë erosion
- Ndalimin e dëmtimit e zhdukjes së shkurreve në zonat rreth kantierit

Restaurimi dhe rehabilitimi i ndikimeve ndaj mjedisit, do të kryhet si një domosdoshmëri në kthimin e pasurive të vlerësuara në kushtet e mëparshme, sa më mirë dhe më shpejt që të jetë e mundur. Kjo do të realizohet, pasi vetë operatori si dhe studimi i linjës bazë të ndikimeve në mjedis që po paraqet kanë identifikuar ndikimet potenciale dhe masat që duhen marrë për parandalimin, minimizimin dhe mënjanimin e ndikimit të tyre.

### ***Plani i Monitorimit te Ndikimit ne Mjedis.***

Ndikimet negative qe pershkruam me siper mund te minimizohen duke marre nje sere masash. Siç kemi theksuar ne shume kapituj te ketij materiali, ndotja qe i shkaktohet mjedisit eshte minimale, jo vetem se kemi te bejme me shfrytezimin e nje burimi te rinovueshem energjie (siç eshte hidroenergja), por se nuk do te kemi HEC me rezervuar (basen uJOR si psh Fierza), qe sjell nje problematike me te medha te mjedisit, por HEC-et e vegjel me derivacion qe shkakton ndotje minimale.



- Monitorimin e parametrave gjeometrik te shkalleve te shfrytezimit te objektit si pjerresia, lartesia, kendi i skarpates, pjerresia e trasese si dhe te parametrave gjeometrik te parashikuar ne projekt.
- Monitorimi i parametrave fizik dhe dinamik te shperndarjes se pluhurit dhe marrja e masave perkatese te parashikuara ne projekt per parandalimin e tij.
- Monitorimi i siperfaqeve te mbushura me material dhe toke vegjetale per parandalimin e shperlarjeve, gerryerjeve, krjimin e gropave etj. Atje ku vihen re demtime te kesaj zone do te merren masa per riparimin e tyre.
- Monitorimin e siperfaqeve te mbjella te pemeve dhe bimeve te kultivuara, si dhe ecurise normale te mbirjes dhe zhvillimit te tyre.
- Monitorimi i cdo siperfaqeje te mbjelle do te vazhdoje per nje periudhe 5 vjecare ku gjate se ciles bimet kane marre nje zhvillimi te konsiderueshem dhe nuk kane nevojë per sherbime.
- Shoqeria investitore merr persiper ecurine normale te punes dhe rruajtjen e vazhdueshme te mjedisit deri ne perfundim.
- Shoqeria investitore gjithashtu do te kete lidhje te vazhdueshme me Agjencine Rajonale te Mjedisit prane se ciles do te informoje periodikisht dhe per monitorimin e parametrave mjedisore.

***Ndikimet e mundëshme në mjedisin ndërkufitarë (nëse projekti ka natyrë të tillë).***

Zbatimi i këtij projekti nuk ka ndikim në mjedisin kufitare pasi kufiri me shtetet fqinje është shumë largë nga zona e projektit.

***Konkluzionet***

1. Projekti ne fjale përputhet me nismen e qeverisë për nxitjen e sektorit privat per prodhimin e energjisë elektrike, nëpërmjet ndërtimit të HEC-ve të cilët do të ndihmojne në rritjen e potencialit hidroenergjitik të Shqipërisë.
2. Vetite fiziko-mekanike te shtresave qe takohen ne bazamentet shkembore dhe gjysemshkembore te veprave hidroteknike te ketyre objekti i plotesojne kerkesat projektimit per sigurine dhe qendrushmerine e tyre.
3. Ndertimi i tubacionit te renies se turbinave, garantojne transportimin e ujit per nevoja hidroenergjitike pa humbje te medha.
4. Ndërtimi i hidrocentraleve, përveç qëllimit kryesor të prodhimit të energjisë elektrike, do të ndikojë pozitivisht dhe në realizimin e disa qëllimeve të tjera si:

- Përmirësimin e kushteve social-ekonomike të komunitetit të zonës.
- Ndertimit te objekteve te prodhimit te energjise elektrike me impakt negativ minimal ne mjedis.
- Punesimit te banoreve te zones si punetoreve dhe specialiste te fushes gjate fazes se ndertimit dhe shfrytezimit te vepres.

5. Nga zhvillimi i aktivitetit do te krijohen mbetje te vogla, inerte apo betoni nga ndertimi i godines se hidrocentralit, trasese se tubacionit te presionit etj. Detyrat kryesore qe do te kete parasysh stafi teknik jane:

- Kontrolli i vazhdueshem i gjendjes se mjedisit ne territorin ku do te zhvillohet aktiviteti.
  - Kontrolli teknik i paisjeve.
- Zbatimi i kushteve qe do te vendosen ne Lejen Mjedisore.
- Mbajtja paster e gjithë territorit ku kryhet veprimtaria.

6. Gjate ndertimit të Hec SHINI dhe shfrytezimit të tij, subjekti Ndertues, krahas problemeve të ngritura në këtë raport V.N.M në veçanti duhet t'i kushtoje rendesi edhe faktoreve te meposhtem:

- Të respektojë procedurat, normat, standartet dhe planifikimet e paraqitura në projekt gjatë realizimit të tij.
- Me vënien e projektit në zbatim, të respektojë dhe të vëre në zbatim programin e monitorimit, për të pasur vazhdimisht tregues mjedisore konform standarteve dhe normave si në aspektin cilësor ashtu dhe në atë sasior.
- Të kontrollojë vazhdimisht ecurinë e treguesve mjedisore të rrjetit hidrik të perrenjve dhe linjave elektrike të transmetimit.
- Ne rast të mosfunksionimit të parametrave sipas standarteve apo normativave, apo ndërhyrjeve arbitrare keqedashëse, të ndërprejë aktivitetin dhe të komunikojë me instancat e pushtetit vendor deri në ato qendrorë për dëmtimet përkatëse.
- Të ketë kontakte të qëndrueshme me komunitetin e zones sidomos me shoqatën e perdoruesve te ujit (SHPU) për garantimin e ujit për pije dhe bujqesi në cdo moment që komuniteti do të ketë nevojë.
- Të kontaktojë vazhdimisht me Autoritetet Mjedisore Rajonale dhe lokale dhe me organizata të tjera të interesuara


*Raporti u përgatit nga:*

**Green-Studio (Liçenca Nr. LN-9472-04-2015)**

*Çertifikat lëshuar nga MMPAU, Nr 361, Nr prot 4935, datë, 22.06.2017*

*Ing. Ervis MALAJ*





REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
**MINISTRIA E MJEDISIT**

Nr. 4935 Prot.

Tiranë, më 22.06 2017

Nr. identifikues 361

## ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":


**Z. ERVIS MALAJ**

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

**MINISTRI**

**Lefter KOKA**





LICENCË



LN-9472-04-2015 NUIS/NIPT: L51607502C

Subjekti: Ervis Malaj

Adresa: Durrës, DURRES, Durrës, Lagjia 7, rruga Hajdar Demiri, pallat 8-katësh, zona kadastrale 8512, nr pasurisë 5/192, kat i parë.

Kodi: III.2.A (1+2) Kod tjetër:

Data e lëshimit: 12/02/2016 Afat i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shtërbme ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis  
2. Auditim mjedisor

Adresa: Durrës, DURRES, Durrës, Lagjia 7, rruga Hajdar Demiri, pallat 8-katësh, zona kadastrale 8512, nr pasurisë 5/192, kat i parë.

Specialiteti

Kategoria

Shtërbme ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Vlerësim i ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislativonin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislativonin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Nënshkrimi i sportellit:

Stull Tazik

